



Vlerësimi Institucional i Institucioneve të Arsimit të Lartë në Shqipëri

**Raporti i Institucionit "Universitetit
Mesdhetar të Shqipërisë"
Qershor 2017**

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM:

- | | | |
|---|-------------------------|---------|
| 1 | Profesor Edward J Esche | Kryetar |
| 2 | Profesor Andy Cobb | Anëtar |
| 3 | Profesor Raimonda Duka | Anëtare |

Përmbajtja

Përmbajtja.....	3
Rreth këtij vlerësimi.....	1
Konteksti i këtij vlerësimi	2
Raport i përmbledhur	3
Përmbledhje e gjetjeve.....	6
Raporti i detajuar.....	8
Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij	8
Fusha e Vlerësimit 2: Burimet	14
Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula	19
Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi.....	24
Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre	29
Lista e dokumenteve	33

Rreth këtij vlerësimi

Qëllimi kryesor i Vlerësimit Institucional është të vlerësojë se në çfarë shkalle institucionet e arsimit të lartë (IAL) përmbushin Standardet Shtetërore të Cilësisë në Shqipëri, që kanë hyrë në fuqi në vitin 2011. Vlerësimi Institucional është procesi i vlerësimit nga grupi i ekspertëve të vlerësimit, që përbëhet nga një ndërthurje e ekspertëve nga Mbretëria e Bashkuar të caktuar nga QAA-ja dhe të ekspertëve shqiptarë të caktuar nga APAAL-i. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm drejtohet nga një ekspert i QAA-së.

Raportet përkatëse nuk shërbejnë vetëm për akreditimin institucional, që mbështetet në shkallën e përmbushjes së standardeve nga IAL-të, por edhe për t'iu ofruar IAL-ve, qeverisë shqiptare, publikut dhe studentëve informacion për mënyrën se si IAL-të përmbushin standardet. Ky raport i ndihmon gjithashtu IAL-të të identifikojnë prioritetet që kanë nevojë për përmirësim (procesi që ofruesit e arsimit të lartë zbatojnë për përmirësimin sistematik të cilësisë së ofrimit dhe mënyrave për mbështetjen e të nxëniet të studentëve).

Standardet Shtetërore të Cilësisë në Shqipëri janë grupuar në pesë kapituj, Fusha Vlerësimi: Organizimi dhe Menaxhimi i tij; Burimet; Kurrikula; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi; si dhe Studentët dhe Mbështetja e tyre. Ky raport identifikon karakteristikat e praktikës së mirë, rekomandimet, pohimet e veprimeve në zhvillim e sipër dhe dobësitë për çdo Fushë Vlerësimi, duke përfshirë gjykimin se në çfarë niveli IAL-ja i përmbush standardet. Format e gjykimit që ekspertët mund të japin janë: standardet janë përmbushur plotësisht; standardet janë përmbushur kryesisht; standardet janë përmbushur pjesërisht; ose standardet nuk janë përmbushur.

Në fund, ekspertët do ta përmyllin punën e tyre duke i rekomanduar Këshillit të Akreditimit të APAAL-it një gjykim të përmbledhur. Gjykimin i përmbledhur është një nga katër nivelet e mëposhtme:

Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur
Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur kryesisht
Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur pjesërisht
Standardet Shtetërore të Cilësisë nuk janë përmbushur.

Në kuadrin e procesit të përgatitjes së raportit, QAA-ja i ka ofruar Grupit të Vlerësimit të Jashtëm mbështetje të specializuar, duke u siguruar që grupi t'i mbështesë gjetjet në raport me fakte, si dhe duke korrigjuar dhe përmbledhur raportin e plotë për përmbledhjen që vijon.

Konteksti i këtij vlerësimi

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë (UMSH; Universiteti), i njohur gjithashtu si SHLP “Mesdhetare e Shqipërisë” (SHLPMSH), është themeluar në vitin 2007 nga një grup intelektualësh, profesorësh dhe ekspertësh me eksperiencë të gjerë në fushën akademike dhe atë të kërkimit shkencor në Shqipëri dhe në rajon. Institucioni është licensuar nga Qeveria e Shqipërisë si një institucion i arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor në vitin 2009, dhe po këtë vit filloi ushtrimin e veprimtarisë së vet në përputhje me Procesin e Bolonjës. UMSH-ja përbëhet nga Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Politike, të cilat ofrojnë programe studimi të Ciklit të Parë Bachelor; Ciklit të Dytë Master i Shkencave dhe Master Profesional; dhe, që në fund të vitit 2017, ofron programin e studimeve të doktoratës të Ciklit të Tretë. Programet e studimit ofrohen në fushën e biznesit, menaxhimit, kontabilitetit, ekonomisë, informatikës, shkencave politike, drejtësisë dhe studimeve evropiane. Programet e studimit mbështeten nga veprimtari kërkimore të koordinuara nga Qendra Kërkimore Shkencore e këtij Institucioni.

Bashkëpunimi kombëtar dhe ndërkombëtar zë vend të rëndësishëm në Planin Strategjik të UMSH-së. Institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me një gamë të gjerë institucionesh vendore, kombëtare dhe Evropiane dhe është gjithashtu pjesë e dy rrjeteve ndërkombëtare universitare.

Raport i përmbledhur

UMSH-ja është institucion privat jofitimprurës, ambientet e të cilit ndodhen në Tiranë. Institucioni ofron programe studimi të ciklit të parë dhe të ciklit të dytë, që zhvillohen në gjuhën shqipe. Universiteti përbëhet nga dy Fakultete: Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Fakulteti i Shkencave Juridike dhe Politike. Misioni i tij është të kontribuojë në zhvillimin e mëtejshëm të arsimit të lartë, nëpërmjet mësimdhënies me cilësi të lartë në fushën e ekonomisë, drejtësisë, politikës, marrëdhënieve ndërkombëtare dhe diplomacisë. Institucioni e realizon këtë nëpërmjet gjashtë departamenteve: Departamenti Financë, Bankë dhe Kontabilitet; Departamenti i Ekonomisë; Departamenti i Informatikës, Matematikës dhe Mbështetës; Departamenti Juridik; Departamenti i Shkencave Politike; dhe Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Në vitin 2016-17, UMSH-ja ka pasur 2,397 studentë të regjistruar në programet e studimit me kohë të plotë.

Një grup prej shtatë vetash në UMSH, që përfshinte drejtues të lartë, stafin akademik, personelin ndihmës dhe një përfaqësues të studentëve ka hartuar një raport vetëvlerësimi (RVV). Grupi i krijuar, ka analizuar dhe përmbledhur një gamë të gjerë materialesh në lidhje me të gjitha aspektet e funksionimit të universitetit. Studenti përfaqësues u përfshi në të gjitha fazat e procesit. Grupi gjithashtu intervistoi një pjesë të stafit dhe studentëve nga të gjitha nivelet e universitetit përpara se ta përmbledhte informacionin në një raport, i cili iu përcoll Rektorit.

Megjithëse raporti ofronte një përshkrim të dobishëm dhe disa vlerësime të sakta të Universitetit, cilësia e RVV ishte e dobët. Versioni në gjuhën angleze i raportit shpesh ishte i vështirë për t'u kuptuar; pohimet nuk kishin referenca të plota dhe në mënyrë të rregullt ose ishin të pamjaftueshme. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm bëri 79 kërkesa shtesë për dokumente dhe sqarimin e pikave të paqarta në RVV. UMSH-ja nuk i ofroi materialet shtesë brenda afatit të kërkuar, por vetëm pak para vizitës së Grupit të Vlerësimit të Jashtëm.

Vizita u zhvillua gjatë dy ditëve, më 8 dhe 9 qershor 2017. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përbëhej nga dy ekspertë të arsimit të lartë nga Mbretëria e Bashkuar dhe një anëtar me përvojë në arsimin e lartë nga personeli i një institucioni shqiptar të arsimit të lartë. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u mbështet nga Menaxheri i Vlerësimit dhe një specialist për mbajtjen e shënimeve të caktuar nga APAAL-i. Grupi mori RVV-në dhe një dosje me dokumente mbështetëse tetë javë përpara vizitës së vlerësimit të jashtëm, dhe më vonë u pajis me dokumentacionin shtesë të kërkuar para vizitës dhe gjatë saj. Në tërësi, 109 dokumentet e vëna në dispozicion e mundësuan grupin të njihje me strukturën, politikën, procedurat e menaxhimit, si dhe natyrën e mësimdhënies dhe veprimtarinë kërkimore që ndërmerrej nga UMSH-ja. Dokumentet përfshinin Statutin e UMSH-së, rregulloret akademike, raportet vjetore, procedurat e pranimit dhe orientimit, një listë të marrëveshjeve me jashtë, shembuj të informimit të programeve si dhe dokumente të mbledhjeve vendimmarrëse.

Gjatë vizitës së vlerësimit të jashtëm, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u takua me drejtues të lartë, studentë, pedagogë, administratorë dhe personelin mbështetës, si dhe me partnerë të jashtëm, punëdhënësit dhe Alumni. Diskutimi i zhvilluar i shërbeu qartësimi të procedurave, përgjegjësi dhe pikëpamjeve. Në të gjitha mbledhjet, ekspertët nga Mbretëria e Bashkuar dhe ata shqiptarë mbajtën shënime. Si pjesë e një vizite në kampua, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vizitoi bibliotekën, auditorët, hapësirën sociale dhe zyrat. Grupi gjithashtu pa një demonstrim të disa prej sistemeve online dhe të informimit elektronik në UMSH. UMSH-ja siguroi përkthim në të gjitha mbledhjet.

Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë përmbushur kryesisht.

Dy Standardet nuk janë përmbushur plotësisht - **Kapitulli III Standardi II.3 dhe Kapitulli III Standardi II.4** - por kjo nuk paraqet rrezik serioz për menaxhimin e kësaj fushe. UMSH-ja vepron në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e saj dhe i përmirëson rregullisht ato. Institucioni menaxhohet në mënyrë efikase, nëpërmjet organeve të tij drejtuese, të tilla si Bordi i Administrimit, Senati dhe Këshilli i Fakultetit, në të cilat stafi angazhohet në debate konstruktive, për të lehtësuar vendimmarrjen. UMSH-ja ka një strategji zhvillimi të harmonizuar me misionin e saj, e cila është hartuar si një Plan Strategjik për vitet 2012-2017. Institucioni është në dijeni të përgjegjësi të tij për sigurimin e cilësisë, për të cilën ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Kurrikulave. UMSH-ja përgatit një raport të plotë vjetor monitorimi, të cilin ua vë në dispozicion të gjithë stafit dhe studentëve dhe ia dorëzon Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. UMSH-ja është mirëorganizuar dhe ka struktura të përshtatshme për të kryer misionin e saj, për t'i ofruar arsim cilësor studentëve të ciklit të parë dhe të dytë, nëpërmjet gjashtë departamenteve të tij në dy fakultete. Megjithatë, ka një mungesë transparence në vendimmarrje në nivelin më të lartë drejtues të UMSH-së, gjë që përbën dobësi.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandon që UMSH-ja, si çështje për t'i kushtuar vëmendje të menjëhershme, të sqarojë me shkrim marrëdhënien ndërmjet Qendrës Mesdheu, Bordit të Administrimit dhe Senatit Akademik, dhe të publikojë procesverbalet e mbledhjeve të Qendrës Mesdheu. UMSH-ja kryen studime të tregut për të përmbushur misionin e saj dhe monitoron punësimin e të diplomuarve të saj. Ai bashkëpunon me partnerët në rang vendor, kombëtar dhe ndërkombëtar në dobi të stafit dhe studentëve të tij. Ka staf ndërkombëtar dhe studentë që ndjekin studimet në UMSH, por nuk ka ndonjë politikë të shkruar për integrimin e stafin ndërkombëtar dhe studentëve, gjë që përbën dobësi. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandon që UMSH-ja në të ardhmen e afërt t'i kushtojë vëmendje hartimit dhe zbatimit të një politike integrimi për stafin dhe studentët e huaj.

Standardet për Burimet janë përmbushur kryesisht. Tre standarde nuk janë përmbushur plotësisht - **Kapitulli III Standardi IV.2; Kapitulli III Standardi IV.4; dhe Kapitulli III Standardi VII.2** - por kjo nuk paraqet rrezik serioz për menaxhimin e kësaj fushe. UMSH-ja rekruton personel në mënyrë të hapur, nëpërmjet një politike transparente njoftimi. Institucioni nuk ka një politikë zyrtare integruese për stafin e tij, që përbën dobësi, megjithëse stafi është në dijeni të përgjegjësive të veta, nëpërmjet kontratave të tyre të punës. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandon që UMSH, si çështje për t'i kushtuar vëmendje në të ardhmen e afërt, të shkruajë dhe të zbatojë një strategji për integrimin e stafit akademik, shkencor dhe atij administrativ. UMSH-ja periodikisht vlerëson aftësitë e stafit të saj. Ai ndjek një politikë për zhvillimin social, por nuk ndjek një politikë për sigurimin e jetës dhe të shëndetit si për stafin vendor, ashtu edhe për atë të ftuar dhe për studentët, që përbën dobësi. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandon që UMSH, si çështje për t'i kushtuar vëmendje në të ardhmen e afërt, të shkruajë dhe të zbatojë një politikë për sigurimin e jetës dhe të shëndetit për stafin vendor dhe atë të ftuar dhe për studentët. UMSH-ja menaxhon buxhetin e saj në përputhje me procedurat e përcaktuara në dokumentet ligjore; gjithashtu pasqyrat financiare janë të vërtetuara nga një auditues i pavarur. Ai ka një sistem të përshtatshëm të menaxhimit të informacionit, nëpërmjet të cilit menaxhon në mënyrë efektive operacionet e veta. Megjithatë, stafi dhe studentët nga jashtë institucionit nuk kanë akses në burimet elektronike, që përbën dobësi. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandon që UMSH, si çështje që kërkon vëmendje të menjëhershme, të zhvillojë sistemin e vet të informacionit për të siguruar që stafi dhe studentët të kenë akses në burimet elektronike edhe nga jashtë institucionit. UMSH-ja menaxhon mirë pasuritë e saj të patundshme dhe e mban Arkivin e saj në përputhje me rregulloren e vet të brendshme. UMSH-ja ka një infrastrukturë të përshtatshme dhe bashkëkohore për ushtrimin e veprimtarisë së saj. UMSH-ja disponon dokumentacionin e plotë të veprimtarisë së saj akademike në format të shtypur.

Standardet për Kurrikulën janë përmbushur plotësisht. Edhe pse Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk ka identifikuar ndonjë karakteristikë të praktikës së mirë, ai nuk ka identifikuar asnjë dobësi. UMSH-ja ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe kriteret e saj të pranimit janë të përcaktuara qartë në rregulloret përkatëse. Programet e studimit, duke përfshirë kurset afatshkurtra, ofrohen në përputhje me strategjinë e saj të zhvillimit me prirjet vendore, kombëtare (veçanërisht ligjore) dhe ndërkombëtare (veçanërisht marrëdhëniet ndërkombëtare). Programet janë të përcaktuara qartë në mënyrë që të kuptohen lehtë dhe të ofrohen brenda kapaciteteve, si njerëzore, ashtu edhe ato fizike të universitetit. Programet e ciklit të parë i pajisin studentët me njohuritë bazë. Ato janë hartuar për të ndihmuar studentët që të përshtaten me universitetin, dhe stafi i UMSH-së i ndihmon gjithashtu në këtë përshtatje.

UMSH-ja ka hartuar programet e vet në përputhje me Procesin e Bolonjës, për të siguruar mundësi për mobilitetin e studentëve në Evropë. Programet e tij studimore kombinojnë punën teorike dhe praktike, gjë që i përgatit studentët për punësim.

Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë përmbushur kryesisht. Një standard nuk është përmbushur plotësisht - **Kapitulli I Standardi II.4** - por kjo nuk paraqet rrezik serioz për menaxhimin e kësaj fushe. Të gjithë komponentët e programeve të studimeve të studentëve janë organizuar dhe zbatuar në mënyrë të efektshme, duke përfshirë edhe ato të caktimit në praktikë profesionale dhe stazh; UMSH-ja i pajis me diplomë studentët që kanë përmbushur të gjitha kërkesat. UMSH-ja siguron që të gjitha programet e studimit të përmirësohen vazhdimisht nën drejtimin e Njësisë së saj të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Kurrikulave. Mungesa e një qasjeje të efektshme institucionale, për të nxitur përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies për të gjithë stafin akademik, përbën dobësi. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandon që UMSH-ja t'i kushtojë vëmendje të menjëhershme zbatimit të një sistemi të efektshëm dhe procedurën shoqëruese për zhvillimin e të gjithë stafit mësimor në mësimdhënie, mësimnxënie

dhe vlerësim. Suksesi i UMSH-së në zhvillimin e kërkimit dhe ndërkombëtarizimit, edhe pse i kufizuar, është i mjaftueshëm për një institucion që nuk ofron programe studimi të ciklit të tretë. UMSH-ja po ndërmer hapa për t'u përmirësuar në dritën e planeve të saj të ardhshme për të hapur programe studimi të ciklit të tretë. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon planin e ri të punës shkencore të UMSH-së bazuar në shtyllat kryesore të prioritetëve kërkimore-shkencore të universitetit, për t'u përqendruar në rezultatet kërkimore. UMSH-ja ofron një nivel të moderuar vazhdimësie për një institucion të ri. Ai i vlerëson kërkimet e tij dhe angazhohet në një sasi të kufizuar transferimesh të rezultateve kërkimore.

Standardet për Studentët dhe Mbështetja e tyre janë përmbushur kryesisht. Një standard nuk është përmbushur plotësisht - **Kapitulli I Standard III.8** - por kjo nuk paraqet rrezik serioz për menaxhimin e kësaj fushe. UMSH-ja ndjek politikën e duhur për pranimin e studentëve të rinj. Ai informon dhe komunikon me stafin e tij dhe studentët në mënyrë efikase me anë të takimeve ballë për ballë, emailit, telefonit, rrjeteve sociale dhe faqes së saj të internetit. Institucioni ka struktura të përshtatshme funksionale për të udhëhequr dhe udhëzuar studentët me anë të programeve të tyre të studimit, duke përfshirë nëpërmjet stafit të tij akademik dhe shërbimeve mbështetëse, veçanërisht Zyrës së Këshillimit të Studentëve dhe të Karrierës. Tutorët udhëzojnë dhe këshillojnë studentët në studimet e tyre të mëtejshme, por disa tutorë këshillojnë deri në 200 studentë.

UMSH-ja mbështet studentë të kategorisë së veçantë, por nuk ofron studime me kohë të pjeshme. Ai ofron literaturë bazë, në format të shtypur dhe elektronik, për nevojat e studentëve, dhe synon të ofrojë më shumë shërbime elektronike bibliotekare. UMSH-ja i nxit studentët që të marrin pjesë në jetën institucionale nëpërmjet mbështetjes së saj të Këshillit Studentor dhe nëpërmjet përfaqësimit të studentëve në organet e tij drejtuese. Megjithatë, institucioni nuk ndjek në mënyrë të mjaftueshme një politikë për të siguruar cilësinë kulturore dhe sportive të jetës studentore, që përbën dobësi. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandon që UMSH-ja në të ardhmen e afërt t'i kushtojë vëmendje hartimin të një politike për të siguruar cilësinë kulturore dhe sportive të jetës studentore. UMSH-ja ndihmon kalimin e studentëve në punë falë Zyrës së saj të përkushtuar të Këshillimit të Studentëve dhe të Karrierës dhe marrëveshjeve të shumta bashkëpunuese me institucione vendore.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstatoi se Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur plotësisht në një fushë dhe janë përmbushur kryesisht në katër fusha.

Përmbledhje e gjetjeve

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi karakteristika të praktikës së mirë.

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- mungesa e transparencës së vendimmarrjes në nivelin më të lartë drejtues (pika 1.8, **Kapitulli III Standardi II.3**)
- mungesa e një politike integruese të shkruar për stafin dhe studentët e huaj (pika 1.12, **Kapitulli III Standardi III.4**)
- mungesa e një strategjie zyrtare integruese për të gjithë stafin (pika 2.2, **Kapitulli III Standardi IV.2**)
- mungesa e një politike për sigurimin e jetës dhe të shëndetit si për stafin vendor, ashtu edhe atë të ftuar dhe për studentët (pika 2.4, **Kapitulli III Standardi IV.4**)
- mungesa e aksesit në burimet elektronike edhe jashtë institucionit për stafin dhe studentët (pika 2.10, **Kapitulli III Standardi VII.2**)
- mungesa e një qasjeje institucionale të efektshme për promovimin e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies për të gjithë stafin akademik (pika 4.4, **Kapitulli I Standardi II.4**)
- mungesa e një politike mbështetëse për të siguruar cilësinë kulturore dhe sportive të jetës studentore (pika 5.8; **Kapitulli I Standardi III.8**).

Rekomandimet

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- t'i kushtohet vëmendje e menjëhershme qartësisimit me shkrim të marrëdhënies ndërmjet Bordit të Qendrës Mesdheu, Bordit të Administrimit dhe Senatit Akademik, dhe publikimit të procesverbaleve të mbledhjeve të Bordit të Qendrës Mesdheu (pika 1.8, **Kapitulli III Standardi II.3**)
- t'i kushtohet vëmendje në të ardhmen e afërt hartimit dhe zbatimit të një politike integruese për stafin dhe studentët e huaj (pika 1.12; **Kapitulli III Standardi III.4**)
- t'i kushtohet vëmendje në të ardhmen e afërt hartimit dhe zbatimit të një strategjie integruese për stafin akademik, shkencor dhe administrativ, veçanërisht për të mbështetur Strategjinë e vet për Ndërkombëtarizim (pika 2.2; **Kapitulli III Standardi IV.2**)
- t'i kushtohet vëmendje në të ardhmen e afërt hartimit dhe zbatimit të një politike për sigurimin e jetës dhe të shëndetit, si për stafin vendor, ashtu edhe atë të ftuar dhe për studentët (pika 2.4; **Kapitulli III Standardi IV.4**)
- t'i kushtohet vëmendje e menjëhershme zhvillimit të sistemit të vet të informacionit, për të siguruar që stafi dhe studentët të kenë akses në burimet elektronike edhe nga jashtë institucionit (pika 2.10, **Kapitulli III Standardi VII.2**)
- t'i kushtohet vëmendje e menjëhershme zbatimit të një sistemi të efektshëm dhe procedurës shoqëruese për zhvillimin e të gjithë stafit mësimdhënës në mësimdhënie, mësimnxënie dhe vlerësim (pika 4.4, **Kapitulli I Standardi II.4**)
- t'i kushtohet vëmendje në të ardhmen e afërt hartimit të një politike që siguron cilësinë kulturore dhe sportive të jetës studentore (pika 5.8; **Kapitulli I Standardi III.8**).

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon veprimet e ndërmarra si më poshtë:

- plani i ri i punës shkencore të UMSH-së bazuar në shtyllat kryesore të prioriteteve kërkimore-shkencore të universitetit, për t'u përqendruar në rezultatet kërkimore (pika 4.8, **Kapitulli II Standardi I.4**).

Përmbledhje e gjykimeve për çdo Fushë Vlerësimi

- 1 Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë **përbushur kryesisht**.
- 2 Standardet për Burimet janë **përbushur kryesisht**.
- 3 Standardet për Kurrikulën janë **përbushur plotësisht**.
- 4 Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë **përbushur kryesisht**.
- 5 Standardet për Studentët dhe Mbështetja e tyre janë **përbushur kryesisht**.

Gjykimi i përmbledhur

Ekspertët i rekomandojnë Këshillit të Akreditimit se në Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë Standardet Shtetërore të Cilësisë **janë përbushur kryesisht**.

Raporti i detajuar

Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij

- 1.1 UMSH-ja u themelua me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 177 dhe vepron me autonomi institucionale dhe liri akademike në bazë të ligjit nr. 9741 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Ai është një institucion privat i arsimit të lartë, laik dhe jopolitik, që ushtron veprimtari mësimdhënies dhe kërkimi. **[RVV fq.7; 5; 1 Nenet 1, 3; 2 fq.1]** Statuti përcakton Misionin e tij sesi të kontribuojë në zhvillimin cilësor të arsimit të lartë në fushën e shkencave politike, marrëdhënies ndërkombëtare dhe diplomacisë, dhe shkencave ekonomike. **[5; 1, Neni 4]** UMSH-ja synon të përgatisë specialistë dhe udhëheqës të shquar në sektorin publik, privat dhe jofitimprurës, dhe të gjenerojë ide që u japin përgjigje dhe zgjidhje sfidave aktuale dhe të ardhshme të vendit dhe zhvillimit rajonal. **[12 fq.3]** UMSH-ja është në pronësi të Qendrës Mesdheu Sh.p.k., e cila merr vendime për zhvillimin dhe zgjerimin e politikave të saj. **[5; 1, Neni 2]** Një strukturë e re e përshkruar nga Grupi i Vetëvlerësimit si një “qasje dinamike për ndryshim” **[RVV fq.6]** është miratuar nga Bordi i Qendrës Mesdheu në vitin 2014, e që ka hyrë në fuqi në vitin 2015. **[3]** Programet e studimeve të ciklit të tretë pritet të fillojnë në vitin 2017. UMSH-ja është aktualisht në pritje të vendimit nga Ministria e Arsimit dhe Sportit për miratimin e Statutit të saj të ri dhe kërkesës për t'u marrë statusin e “Universitet”. **[B1.3] [Kapitulli III Standardi I.1]**
- 1.2 Organi më i lartë administrativ përgjegjës për përmbushjen e misionit të UMSH-së është Bordi i Qendrës Mesdheu, i cili mbledhet të paktën dy herë në vit. Autoritetet drejtuese janë Rektori, Dekani dhe Përgjegjësi i Departamentit. Organet drejtuese kolegjiale janë Senati Akademik, Këshilli i Fakultetit dhe Këshilli i Etikës. **[RVV fq.6-7; 1; 4]** Organizimi dhe përgjegjësitë e këtyre autoriteteve dhe organeve janë të detajuara në Statut. Senati Akademik, i kryesuar nga Rektori, është organ kolegjial, vendimmarrës, që menaxhon dhe organizon veprimtarinë akademike të universitetit. **[RVV fq.6-7; 1, Neni 15]** Ai planifikon, bashkërendon, drejton dhe kontrollon veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë kërkimore, dhe vlerëson efikasitetin e tyre. Rektori është organ ekzekutiv drejtues përgjegjës për zbatimin e vendimeve të Senatit Akademik. Ai përgatit plane afatgjata, harton programin vjetor të veprimtarive, rekomandon projekte për mësimdhënien dhe kërkimin, monitoron dhe publikon vlerësimin e veprimtarive, mbikëqyr numrin e stafit, dhe përgatit Raportin Vjetor për Senatin. **[RVV fq.6-7; 1, Neni 16]** Këshilli i Administrimit mbikëqyr veprimtarinë administrative dhe financiare. Ai miraton kriteret për alokimin e burimeve, harton raportin vjetor financiar dhe vlerëson planet e zhvillimit. **[RVV fq.6-7; 1, Neni 17]** Këshilli i Fakultetit është organ vendimmarrës në çdo Fakultet dhe kryesohet nga Dekani dhe mbledhet të paktën çdo tre muaj. Ai përcakton alokimin e burimeve për departamentet, shqyrton propozimet për programet e reja për mësimdhënien dhe kërkimin përpara dorëzimit në Senat, analizon hapjen dhe mbylljen e departamenteve, prodhon raportin vjetor mbi veprimtarinë mësimore e kërkimore, dhe i paraqet Senatit propozime për planifikim strategjik brenda fakultetit. **[RVV fq.6-7; 1, Neni 18]** Bordi Këshillimor është organ konsultativ me katër anëtarë nga fusha të ndryshme të mësimdhënies dhe kërkimit. Ai mbledhet të paktën dy herë në vit për të shqyrtuar dhe vlerësuar veprimtarinë e UMSH-së dhe planin e saj të zhvillimit. Bordi Këshillimor sugjeron mundësitë për zgjerim dhe komenton mbi përdorimin e burimeve financiare. **[RVV fq.6-7; 1, Neni 19]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm kërkoi dokumente të procesverbaleve të mbledhjeve dhe rezultateve në tre raste, por asnjë prej tyre nuk u vu në dispozicion. **[M12]** Bordi Këshillimor formon Bordin Editorial të revistës “Euromediterranean” dhe është përfshirë në organizimin e tre konferencave në vitin 2010, 2015 dhe 2017. **[D8]** Këshilli i Etikës diskuton çështjet etike dhe propozimet ia paraqet Rektorit të paktën dy herë në vit. **[RVV fq.6-7; 1, Neni 20]** Rektori i shpjegoi Grupit të Vlerësimit të Jashtëm se Këshilli përbëhet nga tre anëtarë të zgjedhur, ku njëri prej tyre është student, **[M1]** por në

Statut përcaktohet se Këshilli përbëhet nga tre persona të zgjedhur nga Senati Akademik, një anëtar i Qendrës Themeluese dhe dy profesionistë të njohur të etikës. **[1, Neni 20]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk arriti ta zgjidhte këtë kontradiktë. Shembuj të fundit të veprimtarisë së përmendur ishin sjellja relativisht e keqe e studentëve të rinj, të cilët merren me pedagogët që bëjnë gabime, **[M1 Rektori]** dhe krijimi i një kodi veshjeje për punonjësit dhe studentët. **[B1.2]** Komisioni i Kërkimit Shkencor është përgjegjës për organizimin e programeve të studimit të ciklit të dytë, **[1, Neni 22]** dhe Këshilli i Profesorëve është përgjegjës për organizimin dhe menaxhimin e studimeve të doktoratës dhe trajnimin pas doktoraturës, që do të funksionojë duke ofruar kurrikula për studimet e ciklit të tretë nga viti 2017. **[1, Neni 21]** Rektori është përgjegjës për organizimin dhe menaxhimin e të gjithë Universitetit dhe emërohet për një mandat katërvjeçar nga Qendra Mesdheu, me pëlqimin e Bordit të Administrimit. **[1, Neni 23]** Dekani është autoriteti akademik që drejton Fakultetin, i cili emërohet nga Rektori për një mandat katërvjeçar. **[1, Neni 24]** Përgjegjësi i Departamentit, i propozuar nga Dekani dhe emëruar nga Rektori, është autoriteti më i lartë në Departament. **[1, Neni 25]** Administratori Akademik emërohet nga Rektori dhe është përgjegjës për drejtimin e përditshëm administrativ dhe financiar të të gjithë universitetit. **[1, Neni 26]** Të gjitha organet vendimmarrëse veprojnë në përputhje me përshkrimet e hollësishme të përcaktuara në Statut në nene të veçanta. **[RVV fq.6-7; 1] [Kapitulli III Standardi I.2]**

- 1.3 UMSH-ja nxit debatin konstruktiv. Materialet për diskutim përcillen përpara mbledhjes së organeve drejtuese. **[13, Neni 4; 4.2; 14, Neni 4, 4.2]** Senati Akademik mbledhet të paktën katër herë në vit dhe vendimet i përcillen stafit akademik, personelit administrativ dhe atij mbështetës. **[1, Neni 15]** Fakultetet dhe departamentet zbatojnë vendimet e Senatit. Vendimet arkivohen, dhe zbatimi i tyre monitorohet. **[B1.1.2.c] [Kapitulli III Standardi I.3]**
- 1.4 Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Kurrikulave dhe Komisioni i Cilësisë vlerësojnë efektshmërinë e proceseve të mësimdhënies, kërkimit dhe administrimit, dhe dorëzojnë raporte periodike në Rektorat. **[RVV fq.8]** Megjithatë, Statuti për Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Kurrikulave, i referohet vetëm për sigurimin e cilësisë së procesit të mësimdhënies. **[1, Neni 1; 10]** Kur u pyet për të sqaruar dallimin midis Njësisë dhe Komisionit, Zëvendës/Rektori, u shpreh se funksionet e tyre ishin në fakt të njëjta. **[M3]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk arriti ta zgjidhte këtë kontradiktë. Një raport i Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Kurrikulave, që i ishte paraqitur Rektorit, përmbante një vlerësim të cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies gjatë semestrit të parë të vitit akademik 2016-2017. Ky raport përfshinte kontrollet në orën e mësimin, pyetësorët e studentëve, performancën në vlerësime dhe hartimin e tezave të provimit. **[B1.8]** UMSH-ja ka angazhuar ekspertë të huaj për të ndihmuar në funksionet e saj. Një profesor i ftuar zhvillonte një lëndë në të Drejtën Evropiane dhe Ekonominë, për të përgatitur studentët për karrierë në BE, meqenëse Shqipëria do të integrohet në të. **[RVV fq.8; B1.8]** Ka mundësi për fonde evropiane, për bashkëpunimin ndërkombëtar dhe mobilitetin e stafit akademik dhe studentëve. Raporti vjetor rendit shembuj të financimit ndërkombëtar dhe mobilitetit, **[12 fq.20-27]** dhe së fundmi ka pasur një përpjekje të suksesshme për financim nga programi Erasmus +, si dhe programi 'Capacity Building Youth' në partneritet me organizata nga 11 vende. **[B1.10] [Kapitulli III Standardi I.4]**
- 1.5 UMSH-a ka një strategji zhvillimi, të hartuar në përputhje me misionin e saj si Plani Strategjik 2012-2017 për zhvillimin institucional, kërkimin shkencor, bashkëpunimin dhe ndërkombëtarizimin, bazuar në legjislacionin shqiptar. Universiteti synon të jetë pjesë aktive e Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë. **[RVV fq.8; 11]** Strategjia ka katër parime kryesore: konsolidimin e fushave të Ekonomisë, Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare; forcimin dhe zgjerimin e marrëdhënieve me universitetet e tjera si në Shqipëri, ashtu edhe jashtë vendit; ndërtimin e marrëdhënieve me institucionet publike në fushat e studimit të UMSH-së; dhe përshtatjen e organizimit institucional me ndryshimet

në legjislacion. Studentët nuk janë konsultuar gjatë përgatitjes së Planit të ri Strategjik dhe as të Raportit Vjetor. **[M6]** Në fund të vitit 2017, UMSH-ja do të ofrojë studime të ciklit të tretë, do të përmirësojë cilësinë e mësimdhënies në përputhje me standardet evropiane, do të zhvillojë kërkimin, do të rrisë kontributin në shoqëri dhe në zhvillimin rajonal dhe global, dhe do të nxisë bashkëpunimin ndërkombëtar. Në dhjetor të vitit 2016, u hartua një raport prej dy faqesh i paraqitur nga Rektori në Bordin e Qendrës Mesdheu, ku shënohen marrëveshje bashkëpunimi me 12 institucione akademike në pesë vende. **[B1.11.1] [Kapitulli III Standardi I.5]**

- 1.6 UMSH-ja ia përcjell Raportin Vjetor Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. **[RVV fq.9; 12]** Raporti më i fundit është një dokument i hollësishëm prej 29 faqesh, i cili detajon veprimtaritë e UMSH-së gjatë vitit. Ky raport është organizuar në shtatë seksione: Zbatimi i Misionit; Zbatimi i Objektivave Vjetore; Të Dhënat e Përgjithshme; Përmbushja e Drejtimit të Studentëve; Bashkëpunimi dhe Kërkimi; Financa dhe Menaxhimi i Burimeve; si dhe Marketingu dhe Vlerësimi. Ky plan 23-pikësh, i prodhuar në gjuhën shqipe dhe i datës 8 qershor 2017, rendit detyrat dhe identifikon personat përgjegjës për kryerjen e tyre, gjë që tregon monitorim dhe mbikëqyrje të qartë. Ekziston edhe një plan veprimi i dalë nga Raporti Vjetor 2015-2016. **[B1]** Stafit akademik ka bërë komente në Raportin Vjetor, duke u përfshirë në dhënien e kontributeve në të mbledhjet e departamenteve. **[M11] [Kapitulli III Standardi I.6]**
- 1.7 UMSH-ja është e organizuar në njësi, sipas disiplinave akademike, me dy Fakultete si njësi kryesore, ku secili ka tre departamente dhe zyrat përkatëse administrative. **[RVV fq.9; 1, fq.10-14]** Departamenti është njësi bazë në UMSH dhe është në qendër të të gjithë veprimtarisë së stafit akademik. Në mbledhjet javore, në të cilat studentët nuk marrin pjesë, ai nxit, bashkërendon dhe administron mësimdhënien, kërkimin dhe veprimtarinë shkencore, duke respektuar lirinë akademike të stafit. **[M4]** Çdo departament i dorëzon Dekanin një përmbledhje të veprimtarive të tij për ta përfshirë në Raportin Vjetor. **[M4]** Qendra për Kërkim dhe Zhvillim bën kërkime dhe merr pjesë në zhvillimin e programeve të studimit. Njësi të tjera, të tilla si biblioteka, i shërbejnë departamenteve. Një kërkesë për detaje të kërkimit të vazhdueshëm dhe për shembuj sesi kërkimi ndikon në zhvillimin e programeve të reja ka marrë përgjigje me një referencë të vetme në një monografi. Nuk u dhanë hollësi të mëtejshme. **[B 1.12]** Faqja zyrtare e UMSH-së përmban informacion për studentët e ardhshëm dhe publikun. **[RVV fq.10; Faqja e internetit] [Kapitulli III Standardi II.1]**
- 1.8 UMSH-ja funksionon përmes integritit vertikal të këshillave të saj, kompetencat e të cilit përcaktohen në Statut dhe në Rregullore. Pikërisht, nëpërmjet anëtarësimit në këto organe, stafi akademik kontribuon në procesin e vendimmarrjes. **[RVV fq.10; 13; 14; 15; 16; B1.1.2.c; B1.1.2.d; M11]** Rezultatet zyrtare i komunikohen stafit dhe studentëve me email nga sekretari i Rektorit. **[M3]** RVV thekson se të gjitha “vendimet i përcillen stafit akademik, si dhe personelit administrativ dhe mbështetës, në mënyrë që të arrihet informimi vertikal dhe horizontal i çdo vendim”. **[RVV fq.7]** Kjo duket se vlen për të gjitha bordet, **[B1.1.2.a; B1.1.2.b; B1.5]** përveç Bordit të Qendrës Mesdheu, veprimtaritë e të cilit nuk kanë procesverbale dhe as nuk janë publikuar. **[M12]** Bordi i Qendrës Mesdheu merr vendime pas shqyrtimit të propozimeve nga organet e brendshme drejtuese të UMSH-së, në përputhje me ligjet dhe rregulloren e arsimit të lartë në Shqipëri. **[1, Neni 2]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk mundi të gjente procesverbale ose dokumente me shkrim të veprimtarive të Bordit të Qendrës Mesdheu. Për më tepër, pavarësisht kërkesave të përsëritura, drejtuesit e lartë nuk ishin në gjendje të qartësonin marrëdhënien midis Bordit të Qendrës Mesdheu, Bordit të Administrimit dhe Senatit Akademik. **[M12]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstatoi se mungesa e transparencës së vendimmarrjes në nivelin më të lartë drejtues përbën **dobësi**, pasi kjo do të thotë se vendimet që mund të ndikonin drejtpërdrejt mbi të gjithë stafin e UMSH-së as nuk janë regjistruar dhe as nuk janë njohur. Ai **rekomandon** që UMSH t'i kushtojë vëmendje të

menjëhershme qartësimin me shkrim të marrëdhënies ndërmjet Bordit të Qendrës Mesdheu, Bordit të Administrimit dhe Senatit Akademik, dhe publikimit të procesverbaleve të mbledhjeve të Bordit të Qendrës Mesdheu. **[Kapitulli III Standardi II.3]**

- 1.9 Studimi i tregut nga UMSH-ja bazohet në Metodologjinë e Eurostat-it për të analizuar tregun e punës në rang kombëtar dhe për të siguruar një analizë të kërkesës dhe ofertës. **[17]** Zëvendës/Rektori ka në plan të kryejë një analizë të detajuar në lidhje me fakultetet e UMSH-së. **[M3]** Nuk ka asnjë dokument të një strategjie apo politike kërkimore të tregut. Një raport, i cili i është paraqitur Rektorit në lidhje me mundësinë e punësimit të studentëve, që kanë marrë gradën Master në Ekonomi dhe Shkenca Politike gjatë viteve 2014-16, ishte bazuar në një pyetësor të zhvilluar nëpërmjet telefonit në vitin 2016 me të gjithë të diplomuarit e ciklit të dytë. Nga 128 studentë të regjistruar në vitin 2014, 81% e të diplomuarve në Shkencat Ekonomike janë punësuar në këtë disiplinë. Për 119 studentët me gradën Master të regjistruar në Shkencat Politike në vitin 2014, 46% janë punësuar në këtë disiplinë. **[18]** 61% e të diplomuarve të ciklit të parë janë të punësuar - 68 % e të cilëve janë punësuar në fushën e tyre të studimit të ciklit të parë dhe 32 % janë punësuar jashtë kësaj fushe. **[B1.14]** Pra, UMSH-ja është informuar në mënyrën e duhur dhe është e vetëdijshme për mundësitë e punësimit të të diplomuarve të vet. **[Kapitulli III Standardi III.1]**
- 1.10 Bashkëpunimi kombëtar dhe ndërkombëtar zë vend fuqishëm në Planin Strategjik. **[RVV fq.11; 11; 19.1; 207]** UMSH-ja kërkon dhe organizon marrëveshje me institucione të arsimit të lartë dhe organizatat që kanë qëllime të ngjashme në zonën evropiane dhe mesdhetare. Programet evropiane synojnë të rrisin mobilitetin e stafit dhe studentëve. **[19.1]** UMSH-ja kishte pesë projekte të pranuar në vitin akademik 2016-2017, katër nga të cilat janë financuar nga BE-ja. Pesë projekte të tjera janë në zhvillim e sipër, me një fokus ndërkombëtar rajonal. Stafi akademik vazhdon të ndjekë veprimtari të ngjashme të mbështetura nga fondet e BE-së dhe Erasmus +. **[B1.15; M10]** **[Kapitulli III Standardi III.2]**
- 1.11 UMSH-ja bashkëpunon me organizata të tjera në procesin e mësimdhënies dhe kërkimit, për të përmirësuar perspektivat e punësimit të të diplomuarve të vet dhe pjesëmarrjen e stafit të UMSH-së në projekte kërkimore. UMSH-ja ka marrëveshje bashkëpunimi me 23 universitete rajonale dhe ndërkombëtare dhe 24 institucione joakademike në Shqipëri. **[RVV fq.12; 19.1; 20]** Stafi gjithashtu bashkëpunon me autoritete të pavarura në Shqipëri që lidhen me sektorin e drejtësisë. Tridhjetë e pesë institucione qeveritare dhe kompani private ofrojnë praktika profesionale/stazhe për studentët e këtij institucioni. **[21]** Alumni përmendën bashkëpunime pozitive kërkimore me stafin akademik dhe faktin që studentët kanë fituar përvojë të dobishme për tezat e tyre të Masterit, nëpërmjet praktikës profesionale. **[M7]** **[Kapitulli III Standardi III.3]**
- 1.12 Draft Strategjia për Ndërkombëtarizim e hartuar kohët e fundit, e menaxhuar nga Zyra Ndërkombëtare, në bashkëpunim me Rektorin, departamentet akademike dhe studiuesit, **[2, Neni 23]** i kushton rëndësi të madhe çështjes së ndërkombëtarizimit, me pesë objektiva strategjike. Këto objektiva shërbejnë për të nxitur dhe mbështetur mobilitetin ndërkombëtar të stafit, studentëve dhe studiuesve; për të nxitur bashkëpunimin në rang ndërkombëtar; për të krijuar dhe zgjeruar një kampus ndërkombëtar dygjuhësh; për të mbështetur suksesin ndërkombëtar të studentëve dhe përfundimin e diplomës së tyre; dhe për të rritur ndërjegjësimin ndërkulturor në administratën e UMSH-së. **[B1.18.b]** Ndërkohë që pranohej se kjo Strategji është e re, Grupit të Vlerësimit të Jashtëm nuk iu vunë në dispozicion dokumente/fakte të tjera që të dëshmonin sesi do të trajtohen këto qëllime strategjike dhe aspiruese, dhe asnjë tregues i progresit të shënuar. UMSH-ja mbështet financiarisht pjesëmarrjen në veprimtari ndërkombëtare në rang institucional dhe personal. **[RVV fq.13; 20]** Në UMSH, vijnë

gjithashtu lektorë të huaj dhe përfaqësues ndërkombëtarë. **[22]** UMSH-ja vë në dispozicion fonde për udhëtime në BE. **[B1.1.1.b; B1.18.a; B1.18.b]** Ky institucion ka aplikuar edhe për programet Erasmus + dhe TEMPUS, për të financuar mobilitetin e stafit dhe studentëve. Deri më sot, vetëm katër studentë janë përfshirë në shkëmbimet studentore. Një student ka marrë pjesë në një aktivitet për lidërsipin; një student tjetër ka udhëtuar drejt Poznan, Poloni, për të marrë pjesë në një kurs trajnimi të programit Erasmus + nga 29 tetor 2015 deri më 6 nëntor 2015; një student ka ndjekur programin “Training Multipliers in Street Campaigning” në Ulqin, Mali i Zi, për periudhën 13-22 nëntor 2015; dhe një tjetër ka marrë pjesë në një seminar mbi papunësinë studentore me studentë nga 12 vende. **[M6; B11]** Bashkëpunimi Ndërkombëtar menaxhohet nëpërmjet Zyrës së Karrierës. **[M7]** Lektorët deklaruan se ekzistonte një politikë integruese për staf dhe studentë të huaj, dhe një prej tyre ka dhënë shembullin personal; megjithatë, kur Grupi i Vlerësimit të Jashtëm kërkoi dokumentacion me shkrim, nuk iu paraqit asnjë i tillë. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstatoi se mungesa e një politike integruese të shkruar për stafin dhe studentët e huaj ishte një **dobësi**. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandon që UMSH në të ardhmen e afërt t’i kushtojë vëmendje hartimit dhe zbatimit të një politike integruese për stafin dhe studentët e huaj (shihni gjithashtu pikën 2.2). **[M11] [Kapitulli III Standardi III.4].**

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi karakteristika të praktikës së mirë.

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- mungesa e transparencës së vendimmarrjes në nivelin më të lartë drejtues (pika 1.8, **Kapitulli III Standardi II.3**)
- mungesa e një politike integruese të shkruar për stafin dhe studentët e huaj (pika 1.12, **Kapitulli III Standardi III.4**)

Rekomandimet

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- t'i kushtohet vëmendje e menjëhershme qartësimi me shkrim të marrëdhënies ndërmjet Bordit të Qendrës Mesdheu, Bordit të Administrimit dhe Senatit Akademik, dhe publikimit të procesverbaleve të mbledhjeve të Bordit të Qendrës Mesdheu (pika 1.8, **Kapitulli III Standardi II.3**)
- t'i kushtohet vëmendje në të ardhmen e afërt hartimit dhe zbatimit të një politike integruese për stafin dhe studentët e huaj (pika 1.12; **Kapitulli III Standardi III.4**)

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohon veprime të ndërmarra.

Gjykimi

Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë përmbushur kryesisht.

Fusha e Vlerësimit 2: Burimet

- 2.1 UMSH-ja ndjek një politikë të hapur punësimi dhe rekrutimi të burimeve njerëzore. Ky institucion publikon organigramën e vet. **[5]** Ai gjithashtu publikon vendet e lira të punës për stafin akademik dhe kriteret e përzgjedhjes. Procedurat e rekrutimit janë përshkruar në mënyrë të përshtatshme. **[RVV fq.14; 2, Nenet 24, 25]** Procesi fillohet nga Dekani, dhe Përgjegjësi i Departamentit përkatës angazhohet plotësisht në këtë proces. **[M4]** Punësimi i personelit mësimdhënies, shkencor dhe administrativ realizohet në përputhje me ligjin nr. 9741, "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë". **[23.1]** Në lidhje me ngritjen në detyrë, procesi për pozicionin e dekanit apo përgjegjësit të departamentit është i hapur për stafin e brendshëm akademik, që plotëson kriteret minimale ligjore dhe ato të brendshme. Sipas ligjit nr. 20 (2015), "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", aplikantët duhet të kenë të paktën gradën Profesor i Asociuar për postin e Dekanit dhe Doktor për pozicionin e Përgjegjësit të Departamentit. Kriteret vendore përfshijnë punën dhe përvojën administrative në universitet, si dhe angazhimet publike në mediane dhe shkruar dhe atë vizive. **[Sqarimet 2.4; Aneksi 2, Neni 26]** UMSH-ja i jep përparësi rekrutimit të kandidatëve të kualifikuar nga universitete të njohura ndërkombëtare dhe që kanë kualifikimet e duhura. **[20] [Kapitulli III Standardi IV.1]**
- 2.2 UMSH-ja nuk ka një politikë zyrtare integruese për personelin e vet. **[M11]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u vu në dijeni për një program të përgjithshëm trajnimi prej katër seancash, që ishte zhvilluar për 10 anëtarë të rinj stafi në periudhën midis 30 shtator dhe 9 dhjetor të vitit 2016. **[B13; M11]** Ky program përfshinte njohjen me Rregulloren e UMSH-së, **[A13]** takime me profesorët sesi të ndërtohet një tezë, udhëzime sesi të vlerësohen studentët, dhe një seminar mbi sfondin kulturor të studentëve. **[M11]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstatoi se mungesa e një politike zyrtare integruese për të gjithë stafin përbën **dobësi. Rekomandohet** që në të ardhmen e afërt UMSH-ja t'i kushtojë vëmendje hartimit dhe zbatimit të një strategjie integruese për stafin akademik, të kërkimit shkencor dhe atë administrativ, veçanërisht për të mbështetur Strategjinë e vet për Ndërkombëtarizim. **[B1.18b, Qëllimi 1, pikat 1 dhe 2, fq. 2]** UMSH-ja organizon veprimtari të ndryshme për stafin në ditët festive dhe ngjarje të tjera të veçanta për integrimin e stafit të vet në jetën e tij shoqërore. **[RVV fq.14 me rrjete të mediave sociale] [Kapitulli III Standardi IV.2]**
- 2.3 UMSH-ja i vlerëson aftësitë e stafit në mënyrë periodike. Ato vlerësohen kur nënshkruhet kontrata **[23.2; 23.3]** dhe hartohen programe për t'i forcuar ato. **[RVV fq.15; B13; M11]** Gjatë vlerësimit vjetor të performancës, menaxheri i linjës përdor një formë për të identifikuar pikat e forta dhe fusha të tjera të zhvillimit profesional. **[24.1, fq.5]** Vlerësimi i stafit realizohet nëpërmjet vetëvlerësimit dhe vlerësimit më të lartë nga përgjegjësi i departamentit, dekani apo rektori, bazuar në të dhëna të marra nga studentët për vlerësimin e mësimdhënies dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Kurrikulave. **[RVV fq.15; 24.1; 24.3]** Një grup vlerësimi nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Kurrikulave ndjek leksione dhe plotëson një analizë prej 15-pikësh, e cila përfshin seksione mbi përmbajtjen, shpërndarjen dhe një përmbledhje. **[24.3]** Gjithashtu, Njësia ndërmerr vlerësimin e mëtejshëm të mësimdhënies dhe mësimnxënies në fakultete. Pranë Fakultetit të Shkencave Ekonomike, kjo përfshinte një analizë të leksioneve, hartimin e tezave të provimit, procedurat për anketimin e studentëve dhe praktikën profesionale. Raporti rendit elementet pozitive dhe fushat për përmirësim nëpërmjet një plan veprimi. Ky plan veprimi përfshin cilësinë e mësimdhënies, njëtrajtshmërinë e vlerësimit, mbikëqyrjen e studentëve gjatë provimit dhe nevojën për gjetjen e një forme për të përmbledhur ecurinë gjatë praktikës profesionale. **[34]** Studentët vlerësojnë pedagogët e tyre, nëpërmjet pyetësorëve në fund të çdo semestri. **[24.2; 33]** Studentët e ciklit të dytë përmendën një rast kur një pedagog po prezantonte një temë të vështirë dhe iu kërkua që të ngadalësonte ritmin e shpjegimit, gjë për të cilën

ai ra dakord. **[M6]** Zyra e Burimeve Njerëzore ofron një vlerësim objektiv vjetor përpara ofertës së kontratës për vitin e ardhshëm. Institucioni publikon kriteret e aplikimit për ngritjen në detyrë të stafit. **[2, Neni 26] [Kapitulli III Standardi IV.3]**

- 2.4 UMSH-ja organizon aktivitete sociale për stafin dhe studentët e saj, duke përfshirë edhe rastet për Dhurimin e Gjakut, aktivitetet për mbledhjen e fondeve për gratë e burgosura, dhe aktivitetet në mbështetje të SOS Fshati i Fëmijëve. Institucioni gjithashtu nxit dialogun social. **[RVV fq.15; <http://umsh.edu.al/news-category/te-reja/>; <http://umsh.edu.al/newscategory/vizite-ne-strasburg/>; <http://umsh.edu.al/news/une-dhuroj-po-ti/>]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstatoi se mungesa e një politike për sigurimin e jetës dhe shëndetit si për stafin vendor, ashtu edhe atë të ftuar ose studentët përbën **dobësi**. **[M6; Sqarime 2.3]** Ai rekomandon që UMSH-ja të ardhmen e afërt t'i kushtojë vëmendje hartimit dhe zbatimit të një politike për sigurimin e jetës dhe të shëndetit si për stafin vendor, ashtu edhe atë të ftuar dhe për studentët. **[M6; Sqarime 2.3] [Kapitulli III Standardi IV.4]**
- 2.5 UMSH-ja zbaton rregulla dhe përgjegjësi të qarta për menaxhimin e efektshëm të burimeve njerëzore, kryesisht nëpërmjet Zyrës së Burimeve Njerëzore. Përgjegjësitë e saj janë të detajuara në mënyrë të qartë në rregulloren e universitetit, **[RVV fq.16; 2, Nenet 24 dhe 25]** të cilat përfshijnë marrëdhëniet midis përkrahimit të punës dhe mënyrës sesi menaxhohen njerëzit. **[23.1; 23.2; 23.3; 5] [Kapitulli III Standardi II.2]**
- 2.6 Buxhetet hartohen në nëntor të çdo viti në departamentet përkatëse dhe miratohen nga Senati. Vendimet përfundimtare merren nga Bordi i Administrimit deri më 31 dhjetor. Fondet ndahen në bazë të listës së zërave për shpenzimet. **[RVV fq.16; 25]** Zërat e zakonshëm të kërkuar përfshijnë libra, pajisje, fonde për ndjekjen e konferencave, dhe shpenzimet për publikimin e artikujve. **[M2]** Rezultatet botohen brenda universitetit, gjë që siguron transparencën e përdorimit të burimeve nga Rektorati dhe Senati Akademik tek stafi. **[M3]** Buxheti i përmbush kërkesat e ligjit për arsimin e lartë, ligjit për organizatat jofitimprurëse, dhe të legjisllacionit për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë. **[Kapitulli III Standardi VI.1]**
- 2.7 Strukturat për menaxhimin financiar dhe zbatimin e politikave janë të përcaktuara në aktet ligjore dhe detyrimet funksionale. **[RVV fq.16; 1; 2]** Për të garantuar objektivitetin e vlerësimit dhe zbatimit të menaxhimit financiar, auditimi i brendshëm kontrollon procedurat e Zyrës së Financave. Përveç Bordit të Qendrës Mesdheu (shihni pikën 1.8), UMSH-ja ndjek një politikë transparente të përdorimit të burimeve, ndjek parimet e kontabilitetit dhe monitoron periodikisht treguesit financiarë. Zyra e Financave vepron në përputhje me standardet kombëtare të kontabilitetit, miratuar me ligjin nr. 9228. Pasqyrat financiare verifikohen nga një auditues i pavarur, publikohen dhe deklarohen në sistemin online të tatim-taksave. **[Sqarime 2.6] [Kapitulli III Standardi VI.2]**
- 2.8 UMSH-ja ka një organ të auditimit të brendshëm që monitoron përdorimin e fondeve dhe materialeve dhe raporton në Bordin e Administrimit sipas rregullave dhe neneve të përcaktuara nga Qendra Mesdheu. **[RVV fq.17; D2.7]** Ekspertë të pavarur kontabël vlerësojnë pasqyrat financiare në mbyllje të tyre, sipas legjisllacionit në fuqi. **[RVV fq.17] [Kapitulli III Standardi VI.3]**
- 2.9 Një sistem i përshtatshëm informacioni vepron në mënyrë efektive për mësimdhënien, komunikimin dhe koordinimin e punës së stafit akademik, personelit administrativ dhe studentëve. **[RVV fq.17]** Kompania "BNT Electronics" monitoron efektivitetin e sistemit të IT-së mbi bazë mujore. **[Sqarime 2.8; 19.1]** Faqja zyrtare dhe rrjetet sociale ofrojnë informacion për universitetin. **[www.umsh.edu.al] [Kapitulli III Standardi VII.1]**
- 2.10 Procesi i komunikimit, duke përfshirë faqen zyrtare të internetit, u riorganizua gjatë vitit akademik 2016-2017 nga Zyra e Teknologjisë së Informacionit. Çdo student dhe

anëtar i stafit ka një llogari personale. Sallat e leksioneve janë të pajisura me kompjutera dhe video projektorë. Labororët dhe bibliotekat kanë kompjutera me programet Windows 7 dhe Microsoft Office. Ka programe të posaçme në dispozicion për gjuhë të huaja, financa dhe shkencat shoqërore. **[RVV fq.18; M6; M9]** Manualët e stafit dhe studentëve përshkruajnë trajnime për stafin dhe studentët. **[Sqarime 2.9]** Nuk ka mjedise virtuale të mësimnxënies dhe UMSH-ja nuk ofron programe të edukimit në distancë. **[M9]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstatoi se mungesa e aksesit në burimet elektronike edhe nga jashtë institucionit për stafin dhe studentët përbën dobësi. **[M5; M]** Ai rekomandon që UMSH-ja t'i kushtojë vëmendje të menjëhershme zhvillimit të një sistemi të vet të informacionit, për të siguruar që stafi dhe studentët të kenë akses në burimet elektronike edhe nga jashtë institucionit. **[Kapitulli III Standardi VII.2]**

- 2.11 Rektori është përgjegjës për funksionimin e të gjithë universitetit dhe si rrjedhim është përgjegjës për menaxhimin e pasurisë. **[1, Neni 23]** UMSH-ja operon në ndërtesa funksionale dhe moderne të hapura në vitin 2012 dhe 2017, të cilat kanë ndriçim të mirë dhe sistem ngrohjeje. Sallat e mësimdhënies janë funksionale dhe të pajisura në mënyrë të përshtatshme. Hapësira sociale është e shpërndarë, me një ambient çlodhës të hapur e të ndriçuar mirë. Sistemi Wi-Fi është i disponueshëm në të gjithë institucionin. **[RVV fq.18; 25; M9]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm ka kërkuar prova të dokumentacionit të çështjeve të sigurisë dhe të përdorimit të ndërtesës, por këto dokumente edhe pse janë përmendur në përgjigjen e UMSH-së ndaj kërkesës, nuk u paraqitën. **[B2; B2.10; B2.11]** **[Kapitulli III Standardi VII.3]**
- 2.12 Arkivi i UMSH-së ndodhet pranë bibliotekës dhe i ruan të dhënat e studentëve në format të shtypur. **[M9]** Ruhen edhe kopje elektronike (shihni pikën 2.15). Të gjitha publikimet konsiderohen si vlerë e shtuar e pasurisë kombëtare dhe janë vendosur në bibliotekë. Ky ambient konsiderohet i përshtatshëm për mirëmbajtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë akademike të UMSH-së (shihni gjithashtu pikën 5.5). **[RVV fq.19; M9]** **[Kapitulli III Standardi VII.4]**
- 2.13 UMSH-ja ka ambiente të përshtatshme për të kryer funksionet e veta, të tilla si sallat e mësimdhënies, sallat e leksioneve, labororët dhe ambiente pune të mirë pajisura. Ambientet për stafin akademik dhe personelin mbështetës janë të përshtatshme. **[RVV fq.19; M9]** Ndërtesa dhe ambientet janë në dispozicion sipas kërkesës së tregut për veprimtari ekstrakurrikulare, të tilla si aktivitete private, shkencore ose sociale. Të ardhurat e gjeneruara në këtë mënyrë përdoren për të përmirësuar më tej infrastrukturën e ndërtesës. **[RVV fq.19-20; D2.11]** Ndërkohë që Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk mundi të gjente asnjë evidencë të një strategjie zyrtare marketingu, vuri re një raport të detajuar mbi studimin e tregut të punës në Shqipëri, të vitit 2015, i cili ishte përdorur për të mbështetur me informacione programet e reja të studimit në këtë Universitet. **[17; M2]** **[Kapitulli III Standardi VII.5; Kapitulli III Standardi VII.6]**
- 2.14 UMSH-ja siguron ambiente dhe infrastrukturë të përshtatshme për veprimtarinë akademike dhe shkencore. Për sa i përket vlerësimit nga ana e Grupit të Vlerësimit të Jashtëm, kërkesat për hapësirë, ndriçim, ngrohje, ftohje, ujë dhe furnizimin me energji elektrike të studentëve, si dhe standardet e higjienës, janë përmbushur, ndërkohë që janë planifikuar përmirësime të mëtejshme. **[RVV fq.20-21; M9]** **[Kapitulli III Standardi V.1]**
- 2.15 Dokumentet e veprimtarisë akademike mbahen në format elektronik dhe të shtypur, në të gjitha nivelet. Ato mblidhen, përpunohen dhe menaxhohen nga Koordinatorin i Fakultetit, **[RVV fq.21; A26]** dhe arkivohen në fund të vitit akademik. Të dhënat e hollësishme të studentëve mbahen nga momenti i regjistrimit deri në diplomimin e tyre dhe përditësohen edhe në mënyrë elektronike dhe në format të shtypur nga sekretaria mësimore. **[RVV fq.21; M4]** **[Kapitulli III Standardi V.2]**

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi karakteristika të praktikës së mirë:

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- mungesa e një strategjie zyrtare integruese për të gjithë stafin (pika 2.2, **Kapitulli III Standardi IV.2**)
- mungesa e një politike për sigurimin e jetës dhe të shëndetit si për stafin vendor, ashtu edhe atë të ftuar dhe për studentët (pika 2.4, **Kapitulli III Standardi IV.4**)
- mungesa e aksesit në burimet elektronike edhe nga jashtë institucionit për stafin dhe studentët (pika 2.10, **Kapitulli III Standardi VII.2**).

Rekomandimet

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- t'i kushtohet vëmendje në të ardhmen e afërt hartimit dhe zbatimit të një strategjie integruese për stafin akademik, shkencor dhe administrativ, veçanërisht për të mbështetur Strategjinë e vet për Ndërkombëtarizim (pika 2.2; **Kapitulli III Standardi IV.2**)
- t'i kushtohet vëmendje në të ardhmen e afërt, hartimit dhe zbatimit të një politike për sigurimin e jetës dhe të shëndetit, si për stafin vendor, ashtu edhe atë të ftuar dhe për studentët (pika 2.4; **Kapitulli III Standardi IV.4**)
- t'i kushtohet vëmendje e menjëhershme zhvillimit të sistemit të vet të informacionit, për të siguruar që stafi dhe studentët të kenë akses në burimet elektronike edhe nga jashtë institucionit (pika 2.10, **Kapitulli III Standardi VII.2**).

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohon veprime të ndërmarra.

Gjykimi

Standardet për burimet janë përmbushur kryesisht.

Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula

- 3.1 Programet e studimit në UMSH janë në përputhje me misionin e universitetit, i cili përqendrohet në formimin e specialistëve në fusha të ndryshme të studimeve shoqërore. Universiteti ofron programe studimi të veçanta dhe ndërdisiplinore, unike në Shqipëri, në dy cikle studimi: gjashtë programe Bachelor dhe 12 programe Master. Programet e studimeve janë të harmonizuara me nevojat e ndryshimeve dhe konkurrencës në tregun e punës. **[RVV fq.22; 11 p. 327 Të dhëna për programet e studimit; M2]** UMSH-ja jep informacion për studentët e ardhshëm në lidhje me programet e veta studimore, nëpërmjet broshurave informuese, faqes së tij zyrtare dhe një fushate marketingu. Universiteti gjithashtu mban kontakte me institucionet e arsimit të mesëm, nëpërmjet Drejtorive Arsimore Rajonale. **[RVV fq.22; 27; <http://umsh.edu.al/Fakultet>; <http://umsh.edu.al/fushata-e-marketingut>; B3.2; M5] [Kapitulli I Standardi I.1]**
- 3.2 Kriteret e pranimit në UMSH dhe procedurat e aplikimit janë të përcaktuara qartë në rregulloret e saj. Ato janë hartuar dhe përditësohen nga një komision i veçantë i profesorëve, duke marrë parasysh kriteret e pranimit të vendosura nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe kriteret specifike të vendosura nga vetë UMSH-ja. Senati Akademik miraton kriteret e pranimit për çdo vit akademik. Kriteret janë në përputhje me ato të përcaktuara nga Ministria për të dy programet e ciklit të studimit. Studimet akademike mund të ndiqen nga shtetasit shqiptarë, me kombësi shqiptar dhe joshqiptarë, por mësimi zhvillohet vetëm në gjuhën shqipe. Rregullorja përcakton qartë rregullat për vlerësimin e aftësive të studentëve. **[RVV fq.22; 2, Nenet 29, 30, 31, 32, 36, 37; B3.3.a; B3.3.b; GID fq.5; M3] [Kapitulli I Standardi I.1]**
- 3.3 Të gjitha programet e studimit që ofron në UMSH janë me kohë të plotë. **[RVV fq.22; 2, Neni 33 fq. 20]** Ky institucion gjithashtu ofron një numër kursesh afatshkurtra, duke përdorur burimet e veta njerëzore dhe në bashkëpunim me partnerë të tjerë vendas dhe të huaj. Propozimet për kurse të tilla vijnë nga departamentet dhe janë të përshtatura, për t'iu përgjigjur kërkesës së tregut për specializim. Kurset janë licensuar dhe akredituar nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. UMSH-ja është në procesin e rinovimit të licensave. **[RVV fq.23; B1.9; B3.4; M3; <http://umsh.edu.al/category/education/>] [Kapitulli I Standardi I.2]**
- 3.4 Programet e studimit në UMSH janë ngushtësisht të lidhura me planin e tij strategjik. Institucioni është në procesin e riorganizimit dhe në fund të vitit 2017 do të hapet një fakultet i ri. Riorganizimi synon të përmirësojë ofertën akademike në përputhje me objektivat afatgjata strategjike, nevojat e tregut të punës dhe politikat e zhvillimit ekonomik. UMSH-ja synon të jetë një universitet që organizon programe studimi të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë të studimeve dhe që ofron cilësi të lartë të mësimdhënies në përputhje me standardet e Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë. **[RVV fq.23; 11 fq.3-5; M1]** Të gjitha programet e studimit integrojnë në mënyrë koherente informacionin mbi diplomat që lëshohen në përfundim të studimeve. **[6 fq.11; 7, Neni 25 fq.13; 8, Neni 24, fq.10; 9, Neni 24, fq.14] [Kapitulli I Standardi I.3]**
- 3.5 UMSH-ja ka një strategji e cila është në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim të Arsimit të Lartë; Strategjinë Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin; dhe nevojat e tregut të punës. Institucioni ofron programe në përputhje me peirjet kombëtare dhe ndërkombëtare. **[RVV fq.22; 11 P.2]** Propozimet për të hapur programe të reja studimore në psikologji sociale, turizëm dhe drejtësi janë të bazuara në zhvillimin e ekonomisë vendore dhe nevojat e tregut të punës. UMSH-ja ka procedura të përshtatshme funksionale për hartimin dhe miratimin e programeve të reja të studimit. Departamentet janë përgjegjëse për hartimin e programeve të reja

të studimit, të cilat gjithashtu diskutohen dhe miratohen nga Këshilli i Fakultetit përkatës. Senati Akademik më pas miraton programet e reja të studimit bazuar në propozimin e Këshillit të Fakultetit. **[1, Nenet 15 dhe 18]** UMSH-ja është pjesë e dy rrjeteve universitare – rrjeti i Universiteteve Euro-Mesdhetare dhe Bashkimi i Universiteteve të Euroazisë - dhe ka unifikuar disa module të veçanta të kurrikulës së vet me ato të disa prej universiteteve të këtyre rrjeteve. **[RVV fq.24; M2; M3; 19.1; B3.11] [Kapitulli I Standardi I.4]**

3.6 Ngarkesa mësimore e stafit akademik është e ndarë në përputhje me aktet nënligjore, rregulloret e Universitetit dhe normat e vendosura në universitetet publike. **[RVV fq.24; 2, Neni. 26, 2; M2]** Ngarkesa e përgjithshme është 1,784 orë në vit. Ngarkesa e punës përcaktohet në kontratat individuale të punës për stafin akademik. Programet e studimeve janë të organizuara në mënyrë të tillë që të sigurojnë një ekuilibër për stafin akademik, duke përfshirë profesorë, si dhe shpërndarjen e ngarkesës mësimore ndërmjet procesit mësimor, kërkimit shkencor dhe punës administrative. Ka edhe dallime në shpërndarjen e ngarkesës së punës ndërmjet stafit akademik dhe atij drejtues. Tejkalmi i ngarkesës së punës kompensohet financiarisht nga universiteti. **[23.2, fq.4, 7.1; 23.3, Aneksi A, 2016; B4] [Kapitulli I Standardi I.5]**

3.7 Studentët informohen në lidhje me programet e tyre të studimit, të cilat janë lehtësisht të kuptueshme. UMSH-ja i publikon të gjitha planet mësimore në faqen e vet. **[RVV fq.25; [http://umsh.edu.al/fakultetet/fakulteti-i-shkencave-ekonomike/](http://umsh.edu.al/fakultetet/fakulteti-i-shkencave-ekonomike/programet-e-fakultetit-teshkencave-ekonomike/); <http://umsh.edu.al/fakultetet/fakulteti-i-shkencave-juridike-dhe-politike/>]** Programet e studimit dhe objektivat e tyre janë të përcaktuara qartë. **[6, fq.5; 7, fq.6; 8, fq.3; 9, fq.7]** Kriteret e pranimit për studentët në çdo nivel studimi janë të përcaktuara qartësisht dhe të publikuara në faqen zyrtare dhe në dokumente të tjera të UMSH-së. **[B3.3.a; B3.3.b; <http://umsh.edu.al/kriteret-e-pranimit/>; M6] [Kapitulli I Standardi I.6]**

3.8 Programet e studimit të ciklit të parë i pajisin studentët me njohuritë bazë, metodat e përgjithshme shkencore, dhe parimet për fushën përkatëse të studimit. Programet lehtësojnë kalimin progresiv nga cikli i parë në ciklin e dytë. **[RVV fq.25; 27]** Syllabuset janë të detajuara dhe përfshijnë njohuritë teorike dhe zbatimin në praktikë të këtyre njohurive. **[6; 7; 8; 9; 52]** Çdo program studimi është licensuar nga Këshilli i Ministrave ose Ministria e Arsimit. **[27]** Vëmendje i është kushtuar aftësive të veçanta, që përfshijnë gjuhët e huaja, njohuritë kompjuterike, shkrimin akademik dhe punën praktike. **[6, fq.23-25; 8; RVV fq.12-17]** UMSH-ja mundëson transferimin e studentëve nga institucionet e tjera. Rregulloret e Universitetit dhe aktet e veçanta ligjore janë të miratuara nga organet drejtuese të universitetit dhe përcaktojnë kriteret dhe procedurat e transferimit. **[RVV fq.25; 2 Neni 45-47; B3.6.a; B3.6.b]** Programet e studimit lejojnë përgatitjen e specialistëve të ardhshëm me një formim të përgjithshëm shkencor dhe qytetar. **[RVV fq.25; B3.7] [Kapitulli I Standardi I.7]**

3.9 UMSH-ja lehtëson ambientimin e studentëve në ambientet e universitetit. Institucioni organizon një javë orientimi për studentët e rinj. Programet e studimeve hartohen në mënyrë të tillë që gjatë kësaj jave të zhvillohen leksionet hyrëse për modulet. Stafi mësimor ka vendosur një shumëllojshmëri metodash alternative të mësimdhënies në përgjigje të nevojave të studentëve. **[RVV fq.26; B3.8; 2, Kapitulli VI, Neni 28, pika 6; 52]** Institucioni ofron bursa për të ndihmuar studentët që të përfundojnë studimet e tyre. Procedurat janë të përcaktuara në Aneksin A të Kontratës së studentit. **[6, fq. 21; M5]** Rekrutimi i stafit të ri bazohet në kriteret e mëposhtme: përvoja në mësimdhënie, në kërkimin shkencor dhe ajo profesionale. Kanë prioritet kandidatët e diplomuar në universitete jashtë vendit. **[RVV fq.26; 20]**

Stafi akademik me kohë të plotë zhvillon 79 % të kurrikulës. [RVV fq.26; B3.12] **[Kapitulli I Standardi I.8]**

- 3.10 UMSH-ja ka ngritur grupe pune për hartimin dhe zhvillimin e kurrikulave të programeve të studimit të ciklit të dytë. Anëtarët e këtyre grupeve janë nga stafi që është aktiv në kërkimin shkencor në fushat e tyre përkatëse ose, herë pas here, ekspertë të disiplinave të ngjashme në institucionet partnere. Programet e studimit Master i Shkencave janë hartuar për të mbështetur politikën kërkimore të UMSH-së. Disa punë kërkimore, të tilla si integrimi në BE apo uljen e kredive të këqija, janë përfshirë gjithashtu në kurrikulën përkatëse. [RVV fq.26; 3.11; M10; M11] UMSH-ja fton përfaqësues nga komuniteti i biznesit dhe të ftuar të huaj që punojnë në institucione kombëtare dhe ndërkombëtare, për të mbajtur leksione dhe për të ndarë përvojën e tyre profesionale. [<http://umsh.edu.al/perfaqesues-biznesi/>; 22; M7] Universiteti mbledh informacion mbi punësimin e të diplomuarve dhe ia raporton atë Rektorit. [RVV fq.26; 18] Universiteti angazhon vetëm staf akademik me grada shkencore për të dhënë mësim në ciklin e dytë të studimeve në përputhje me kërkesat ligjore. Stafi akademik me kohë të plotë zhvillon 71% të programit mësimor për programet e studimit të ciklit të dytë. [RVV fq.27; 20; B3.12] **[Kapitulli I Standardi I.9]**
- 3.11 Të gjitha programet e studimit në UMSH janë të organizuara në përputhje me Procesin e Bolonjës në kredite evropiane, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), që lehtëson mobilitetin e studentëve shqiptar në Evropë. [6, Kapitulli IV, Neni 16, fq.10; 7, Kapitulli IV, Neni 17, fq.11; 8 Kapitulli IV, Nenet 16-17, fq.10; 9, Kapitulli IV, Nenet 16-17, fq.10] UMSH-ja aktualisht ofron 12 prej 18 programeve të saj të akredituara të studimit [GID fq.5] Ai lëshon diplomë në fund të çdo programi studimi që shoqërohet me suplementin e diplomës në gjuhën shqipe dhe angleze. [RVV fq.27; B3.5] Programet e studimit mundësojnë ekuivalentimin dhe transferimin e krediteve sipas sistemit evropian. Syllabuset për secilin modul janë të shkruara në gjuhën angleze, gjë që ndihmon me transferimin në universitetet evropiane. [RVV fq.27; 6-9] UMSH-ja nxit përvetësimin e gjuhëve të huaja, kryesisht të anglishtes, nëpërmjet moduleve në gjuhën angleze dhe literaturës së rekomanduar në gjuhën angleze në modulet e tjera. Studentët në ciklin e dytë të studimeve i nënshtrohen provimit të gjuhës angleze, siç kërkohet nga ligji i arsimit të lartë. [nr. 80/2015; 7, Neni 14; 9, Neni 14] UMSH-ja lejon transferimin e krediteve pa vlerësim në kuadrin e marrëveshjeve të përbashkëta me universitete të huaja. [RVV fq.27; 19.1; B3.11] **[Kapitulli I Standardi I.10; Kapitulli I Standardi I.11]**
- 3.12 Programet e studimeve synojnë të balancojnë teorinë me praktikën, nëpërmjet përfshirjes së ushtrimeve praktike dhe seminareve në mbështetje të leksioneve, gjë që është e përshkruar qartë në syllabuse. [6-9; 52] Studentët në këtë mënyrë mund të zbatojnë në praktikë njohuritë dhe aftësitë e ofruara nga programet e studimit. Një shembull i mirë është pjesëmarrja e studentëve në debatin për buxhetin e shtetit në Kuvendin e Shqipërisë. UMSH-ja ofron gjithashtu seanca praktike për përdorimin e programeve profesionale kompjuterike të kontabilitetit dhe gjuhës angleze si një modul ekstrakurrikular. [RVV fq.28; <http://umsh.edu.al/news/mesdhetari-ne-kuvendin-e-shqiperise/>; M7] Të gjitha programet e studimit përfshijnë përgatitjen e një teze diplome. Rregullat dhe standardet për shkrimin dhe vlerësimin e tezës janë të përcaktuara qartë në programin e studimit dhe në rregullore. [30; 2, Neni 39, fq.22] UMSH-ja organizon aktivitete të veçanta me pjesëmarrjen aktive të studentëve. Veprimtari ekstrakurrikulare përfshijnë vizitat në gjykata, panairi i ideve, pjesëmarrjen në konferenca, në kinemanë politike, në takime me Këshillat e Studentëve nga universitete të tjera, si dhe workshop-e për BE-në. [RVV fq.28; <http://umsh.edu.al/kinemaja-politike/>; <http://umsh.edu.al/kërkim->

[shkencor/promovime/](http://umsh.edu.al/panairi-i-ideve/); <http://umsh.edu.al/panairi-i-ideve/>;
<http://umsh.edu.al/kinemaja-politike/>; M5] [*Kapitulli I Standardi I.11*]

- 3.13 Kurrikula synon të përgatisë studentët për tregun e punës dhe çdo program studimi përcakton qartë mundësitë e punësimit për studentët. Programet e studimit shpesh ofrojnë module të veçanta me njohuri nga fusha socio-ekonomike dhe module që lidhen drejtpërdrejt me fushën e specializimit të punësimit. Studentët duhet të ndjekin gjithashtu një praktikë të detyrueshme profesionale ose stazh, që përfshihet në kurrikul. UMSH-ja ka 35 marrëveshje bilaterale me institucione publike dhe kompani private, për të lehtësuar praktikën profesionale të studentëve. [RVV fq.28; 6, fq.5, 23-24; 7 fq.6, fq.27; 8, fq.4, fq.12-17; 9, fq.8, p.16; 21; M7; M11] [*Kapitulli I Standardi I.12*]

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi karakteristika të praktikës së mirë.

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi dobësi.

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha rekomandime.

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohon veprime të ndërmarra.

Gjykimi

Standardet për kurrikulën janë përmbushur plotësisht.

Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi

- 4.1 UMSH-ja ka procedura të përshtatshme funksionale për të siguruar organizimin dhe dokumentimin efikas të programeve të studimeve. Departamentet mbajnë të gjithë dokumentacionin, që përfshin plane mësimore dhe modele standarde të syllabuseve të moduleve. UMSH-ja gjithashtu ka procedura funksionale që rregullojnë përmirësimin dhe përditësimin e programeve të studimeve. Departamentet dhe/ose stafi akademik propozojnë ndryshime të programeve dhe Këshilli i Fakultetit përkatës i miraton ato. [RVV fq.29; 31, fq.3] UMSH-ja koordinon punën e stafit akademik për të siguruar zhvillimin e plotë të kurrikulës për çdo program studimi. Puna dhe, nëse është e nevojshme, trajnimi i duhur i anëtarëve të stafit akademik planifikohen në fillim të vitit të ri akademik. Kjo procedurë përfshin bashkëpunimin ndërdisiplinor ndërmjet departamenteve. [M2; M11; B4] Praktikant profesionalë menaxhohen mirë, për të vlerësuar arritjet e studentëve. Puna praktike e studentëve monitorohet dhe vlerësohet nga personat e caktuar në institucionin pritës. Ata bëjnë ndërlidhjen me pedagogët në universitet. [RVV fq.29; 21; B4.2; M5; M7; B9; B10] UMSH-ja vë në dispozicion literaturën kryesore, të rekomanduar dhe literaturën shtesë për studentët e saj, për të gjitha programet e studimit. Studentët u shprehën se kanë akses shumë të mirë në botime të mjaftueshme të teksteve shkollore, revistave akademike dhe literaturës në gjuhë të huaja. [M5; M6; Pyetësori i studentëve, 11.iv dhe 13.ix] Përveç materialit të duhur në format të shtypur ka edhe një bibliotekë elektronike, e cila përbëhet nga materiale të skanuara të specifikuara për kurset. UMSH-ja gjithashtu ofron materiale audiovizive në mbështetje të mësimdhënies, sidomos për modulet e të drejtës ndërkombëtare dhe shkencave politike. [RVV fq.29; M9; <http://umsh.edu.al/kinemaja-politike/>] [Kapitulli I Standardi II.1; Kapitulli I Standardi II.3]
- 4.2 Rregullat dhe kërkesat e provimeve miratohen nga Senati Akademik dhe bëhen të njohura në Rregulloret e UMSH-së, rregulloret e programeve të studimit si dhe syllabuset e moduleve. [2, Nenet 36 dhe 37, fq.21-22; 6, Kapitulli V; 7, Kapitulli V; 8, Kapitulli V; 9 T, Kapitulli] Kriteret e diplomimit miratohen nga Senati. Të gjitha informacionet në lidhje me procesin e diplomimit publikohen në faqen zyrtare të internetit. [RVV fq.30 <http://umsh.edu.al/procesi-i-diplomimit/>; 32.1; 32.2; 32.3] Administrimi i vlerësimeve të studentëve të kurseve është proces konfidencial që kryhet nga sekretaria mësimore. Sekretaria mësimore gjithashtu i njofton studentët për notat e tyre të provimeve jo më vonë se pesë ditë pas provimeve, me anë të një emaili personal. Studentët kanë dy ditë afat për t'u ankuar tek Dekani, i cili ngre një komision për të shqyrtuar rastin. Ato gjithashtu mund të konsultohen me pedagogët për rezultatet e provimeve të tyre. Studentët pohuan se vlerësimi është konfidencial dhe se kanë marrë përgjigje të kënaqshme për ankesat e tyre. [RVV fq.30; M5; M6; B4.6] Studentët që plotësojnë të gjitha kërkesat e kursit të tyre, të detajuara në programin e studimit, marrin një diplomë, një listë zyrtare notash dhe suplementin përkatës të diplomës. [2, Neni 51, fq.27; B3.5] [Kapitulli I Standard II.2]
- 4.3 Universiteti ka procedura funksionale për të monitoruar procesin mësimor. Leksionet vlerësohen në disa mënyra, të tilla si: monitorimi i përditshëm nga sekretaria mësimore mbi zhvillimin e orëve të mësimit; vlerësimi i stafit nga përgjegjësi i departamentit; dhe monitorimi i cilësisë së mësimdhënies nga ana e Komisionit të Cilësisë të ngritur për këtë qëllim nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Kurrikulave. [RVV fq.30; 24.1; 24.3] Studentët përfshihni edhe në vlerësimin e leksioneve. Para çdo provimi për modulet, studentët plotësojnë një pyetësor. Pyetësorët përpunohen nga ana statistikore dhe pedagogët i shqyrtojnë të gjitha rezultatet pasi janë shënuar notat përfundimtare. Të dhënat përdoren për të

hartuar raporte dhe për të bërë rekomandime në përmirësim të syllabuseve të programeve të studimit, procesin e mësimdhënies dhe infrastrukturën e mësimnxënies. Komisioni, që ka kryer vlerësimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies për vitin akademik 2015-2016, hartoi rekomandime të vlefshme, të tilla si unifikimi i procedurave për të përgatitur provimet e ndërmjetme dhe ato përfundimtare, përmirësimi i raportimit në lidhje me praktikën profesionale, dhe instalimi i softuerit për zbulimin e plagjiaturës, që të kontrollohet puna e studentëve. [RVV fq.31; 24.2; 33; 34] Në fund të çdo viti akademik, dhe jo më vonë se më 30 maj sipas rregullores, departamentet diskutojnë përmirësimin e syllabuseve, duke përfshirë edhe metodat e reja të mësimdhënies dhe përditësimin e literaturës. [31, fq.2] UMSH-ja mbledh të dhëna në lidhje me punësimin e studentëve të diplomuar, por nuk u paraqit asnjë evidencë sesi këto të dhëna përdoren për të përmirësuar cilësinë e programeve të studimit. [18] [Kapitulli I Standardi II.3]

4.4 Departamentet dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë janë përgjegjëse për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Nuk ka asnjë nxitje specifike për eksperimentim në mësimdhënie. Pedagogët me përvojë zakonisht punojnë me stafin e ri, të cilët fillojnë si asistent pedagogë. Në këtë mënyrë, pedagogët me përvojë ia përcjellin metodologjitë e tyre të mësimdhënies stafit të ri, që transmeton njohuritë pedagogjike nga një brez në tjetrin. Pedagogët e brendshëm me përvojë gjithashtu organizojnë trajnime për stafin e rekrutuar rishtazi, por një gjë e tillë përqendrohet më shumë në aspekte të ligjit dhe të rregullores. Trajnimi pedagogjik për stafin e ri apo atë me përvojë të mësimdhënies nuk organizohet në mënyrë sistematike, por herë pas here. [RVV fq.32; M2; M3; B13] Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstatoi se mungesa e një qasjeje të efektshme institucionale për promovimin e përmirësimit të vazhdueshëm në cilësinë e mësimdhënies për të gjithë stafin akademik përbën **dobësi**. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **rekomandon** që UMSH t'i kushtojë vëmendje të menjëhershme zbatimit të një sistemi të efektshëm dhe procedurës përkatëse për zhvillimin e të gjithë stafit mësimdhënës në mësimdhënie, mësimnxënie dhe vlerësim. [Kapitulli I Standardi II.4]

4.5 Departamenti është njësia kryesore mësimore dhe kërkimore. Departamentet janë përgjegjëse për zhvillimin dhe menaxhimin e kërkimit dhe organizimin e bashkëpunimit ndërmjet departamenteve. Departamentet organizohen në grupe mësimore e kërkimore. Drejtuesi i njësisë koordinon punën mësimore dhe kërkimore. [RVV fq.32; 2, Neni 10, 2; B4.9.a; B4.9.b] Stafit akademik ka lirinë për të ndjekur interesat e tij kërkimore, me kusht që të ndjekë drejtimin e përgjithshëm të departamentit. Departamenti është përgjegjës për mbarëvajtjen e punës kërkimore-shkencore dhe, bazuar në rezultatet kërkimore të stafit, bën propozimet përkatëse në lidhje me programin kërkimor për vitin e ardhshëm akademik. [RVV fq.32; 35; B4.12] UMSH-ja mbështet financiarisht stafin akademik për të marrë pjesë në konferenca, për të mbuluar shpenzimet e botimit dhe për të marrë leje për studime. Financimi është i kufizuar dhe janë alokuar vetëm disa shuma të vogla. Gjithashtu janë siguruar disa financime të jashtme në fushën kërkimore, duke përfshirë financimin nga programi Erasmus + [12 fq.27-28; M3; M12; 25; 35; <http://umsh.edu.al/news/konference-shkencore-gjirokastra-ne-tre-dhjetvecaret-e-ardhem/>] [Kapitulli II Standardi I.1]

4.6 UMSH-ja nxit krijimin e grupeve të reja kërkimore shkencore. Projektet zhvillohen nga një grup kolegësh bazuar në specializimet e tyre apo në fusha të ngjashme interesi. Studentët që janë duke shkruar tezën e Masterit të tyre mund të bëjnë pjesë në grupet e kërkimit nën udhëheqjen e profesorëve. UMSH-ja është e angazhuar në kërkime shkencore, gjë që konfirmohet nga financimin prej saj i projekteve kërkimore. Ky institucion gjithashtu koordinon kërkimin e tij me institucione të tjera të

krahasueshme, institucione të pushtetit qendror dhe vendor, si dhe me institucione private. [RVV fq.33; B3.11; B4.11; 35] [Kapitulli II Standardi I.2]

- 4.7 UMSH-ja ndjek një politikë ndërkombëtarizimi të kërkimit përmes marrëveshjeve me institucione të huaja akademike. Ky institucion ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me 22 institucione ndërkombëtare akademike nga rajoni i Ballkanit dhe më gjerë. Gjithashtu, ai është anëtar aktiv i dy rrjeteve universitare. [19.1; B1.18.b] Pjesëmarrja e stafit në konferenca ndërkombëtare është rritur në dy vitet e fundit; Megjithatë, vetëm 34.4% e stafit akademik me kohë të plotë ka marrë pjesë në konferenca për vitin akademik 2016-2017. Stafi akademik ka publikuar artikuj shkencorë, por vetëm katër artikuj janë publikuar në revista ndërkombëtare shkencore me vlerësim nga ekspertë të jashtëm. UMSH-ja ka organizuar disa konferenca kërkimore dhe të lidhura me kërkimin në tre vitet e fundit. [RVV fq.33; 34; B4.14.a; B4.14.b; M3] Institucioni synon të rrisë ndërkombëtarizimin e kërkimit të tij, dhe për këtë qëllim ka hartuar një Strategji të re Ndërkombëtarizimi, për zbatim në periudhën 2017-2022. [RVV fq.33; B1.18.b, Qëllimi 2] [Kapitulli II Standardi I.3]
- 4.8 Kërkimi i UMSH-së është në përputhje me misionin dhe vizionin e tij. Prioritetet kërkimore, bazuar në zhvillimin rajonal dhe kombëtar, janë përcaktuar nga grupe kërkimore dhe përgjegjësit e departamentit. UMSH-ja nxit debatin për prioritetet e tij kërkimore në nivel departamenti. Drejtuesi i Qendrës së Kërkimeve Shkencore hartoi në fund të vitit 2016, për zbatim duke filluar nga viti 2017, një plan shkencor të punës bazuar në shtyllat kryesore të prioriteteve kërkimore-shkencore të universitetit, për t'u përqendruar në rezultatet kërkimore. Plani u miratua nga Rektorati në tetor të vitit 2016. [RVV fq.34; B4.12; B15; M4] Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon planin e ri të punës shkencore të UMSH-së bazuar në shtyllat kryesore të prioriteteve kërkimore-shkencore të universitetit, për t'u përqendruar në rezultatet kërkimore. [Kapitulli II Standardi I.4]
- 4.9 UMSH-ja siguron burimet njerëzore dhe infrastrukturore për zbatimin e prioriteteve kërkimore të përcaktuara nga departamentet. [RVV fq.34] Veprimtaria e tij kërkimore është përqendruar në zbatimin e prioriteteve të kërkimit shkencor. UMSH-ja alokon një mesatare prej 3.5% të buxhetit vjetor për trajnimin e stafit të ri akademik, për organizimin e konferencave dhe për mbështetjen e pjesëmarrjes së stafit të vet në konferenca ndërkombëtare. [25; M3] Institucioni rekruton staf të kualifikuar akademik dhe kërkimor dhe i jep përparësi aplikantëve të cilët kanë gradën Doktor ose janë në procesin e shkrimit të tezës së tyre të doktoratës. Studiues të rinj janë atashuar pranë studiuesve me më shumë përvojë në grupet kërkimore. [RVV fq.34; 20; M1; M2; M10] [Kapitulli II Standardi I.5; Kapitulli II Standardi I.6]
- 4.10 UMSH-ja ka një strategji pesëvjeçare për kërkime shkencore dhe monitoron me kujdes zbatimin e objektivave të saj. Prioritetet e kërkimit shkencor janë në qendër të objektivave institucionale. [RVV fq.35; 11] UMSH-ja fton staf të huaj akademik për të marrë pjesë në mësimdhënie me kohë të pjesshme dhe në leksione të hapura. [B1.18.a] Kjo lehtëson mobilitetin e stafit akademik, duke siguruar fonde për pedagogët që marrin pjesë në projekte afatshkurtra. Universiteti gjithashtu mbështet publikimin e punës kërkimore të stafit akademik. Ai ka vendosur bashkëpunim me disa institucione kërkimore kombëtare, të tilla si Akademia e Shkencave, Universiteti i Tiranës dhe INSTAT-i. [M3; 19.1] [Kapitulli II Standardi I.6]
- 4.11 UMSH-ja mbështet botimin e rezultateve në fushat e saj të kërkimit shkencor. Të gjitha botimet e këtij institucioni nën logon e vet diskutohen në nivel departamenti. [<http://umsh.edu.al/revista-euromediterranea>; <http://umsh.edu.al/botime/n/>] UMSH-ja ka organizuar disa workshop-e dhe seminare, duke krijuar në këtë mënyrë një traditë afatshkurtër kërkimi. Stafi akademik, si autorë apo bashkautorë, ka marrë

pjesë në konferenca të UMSH-së që trajtojnë kulturën kërkimore në nivel rajonal dhe kombëtar. **[RVV fq.36; B4.14.a; B4.14.b] [Kapitulli II Standardi I.7]**

- 4.12 UMSH-ja vlerëson dhe transferon rezultatet e kërkimeve të saj shkencore. Institucioni ka një komision të posaçëm, të përbërë nga Dekani, Zëvendës/Rektori dhe Përgjegjësi i Burimeve Njerëzore, për të monitoruar dhe vlerësuar periodikisht rezultatet e punës kërkimore shkencore të stafit të tij akademik. **[RVV fq.36]** Ky proces realizohet kryesisht nëpërmjet raporteve të hartuara nga departamentet. Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë monitoron dhe regjistron rezultatet e projekteve kërkimore dhe rezultatet konkrete të tilla, si botimet kombëtare ose ndërkombëtare me faktor impakti, konferencat e zhvilluara si dhe transmetimin e rezultateve të kërkimit shkencor në shoqëri. **[RVV fq.36; M12 Administrata]** UMSH-ja pasqyron rezultatet e kërkimit të saj shkencor nëpërmjet organizimit të konferencave, publikimeve dhe zhvillimit të leksioneve. UMSH-ja boton një revistë, Euromediterranean, ku kontribuuesit kryesorë janë stafi i këtij institucioni. Kjo revistë shpërndahet në shumë universitete në rajonin e Ballkanit. **[RVV fq.36; B4.16] [Kapitulli II Standardi I.8]**

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi karakteristika të praktikës së mirë.

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësinë e mëposhtme:

- mungesa e një qasjeje institucionale të efektshme për promovimin e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies për të gjithë stafin akademik (pika 4.4, **Kapitulli I Standardi II.4**).

Rekomandimet

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimin e mëposhtëm:

- t'i kushtohet vëmendje e menjëhershme zbatimit të një sistemi të efektshëm dhe procedurës shoqëruese për zhvillimin e të gjithë stafit mësimdhënës në mësimdhënie, mësimnxënie dhe vlerësim (pika 4.4, **Kapitulli I Standardi II.4**)

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon veprimin e ndërmarrë si më poshtë:

- plani i ri i punës shkencore të UMSH-së bazuar në shtyllat kryesore të prioriteteve kërkimore-shkencore të universitetit, për t'u përqendruar në rezultatet kërkimore (pika 4.8, **Kapitulli II Standardi I.4**).

Gjykimi

Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë përmbushur kryesisht.

Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre

- 5.1 UMSH-ja ndjek politikën e duhur për pranimin e studentëve të rinj. Sekretaria Mësimore dhe Zyra e Pranimeve, dhe Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe e Karrierës kanë përgjegjësi për informimin e studentëve të ardhshëm. Së bashku, ata realizojnë vizita në shkollat e mesme, organizojnë ditët e hapura dhe fushata rekrutimi me të gjitha format e mediave, përfshirë edhe faqen e tyre të internetit. Ato gjithashtu ofrojnë këshillim të mëtejshëm gjatë regjistrimit. **[RVV fq.37; M5]** Kriteret e pranimit, të cilat përcaktohen nga Këshilli i Fakultetit në konsultim me departamentet dhe më pas miratohen nga Senati Akademik, pasqyrohen qartë në Rregullore. **[RVV fq.37; 4, Nenet 29 deri 32; 1, Neni 6e, Neni 15I, Neni 18e, Neni 28, fq.13]** Informacionet në lidhje me kriteret e pranimit dhe procedurat e aplikimit bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të UMSH-së, në broshurën informuese dhe në media gjatë fushatës së rekrutimit. **[faqja e internetit]** UMSH-ja mirëpret studentët e huaj në pajtim me udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. **[RVV fq.37]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u informua se ka një plan prej katër pikash në një dokument politikash për integrimin e studentëve të huaj, por evidencat e paraqitura bënë fjalë vetëm për lektorët. **[M11; B13]** Universiteti organizon një javë orientimi me aktivitete, që përfshijnë një vizitë në ambientet e universitetit dhe leksione të hapura për punësimin dhe karrierën, funksionimin e universitetit, përmbledhje akademike, ditët e bibliotekës dhe fakultetit. **[Sqarime 5.5; B3.8; M5]** Orari i punës së stafit për studentët afishohet në ambientet e tij dhe publikohet në faqen e internetit. **[M11 Mësimdhënia]** UMSH-ja ka lidhje të efektshme me Drejtorinë Arsimore Rajonale dhe Zyrat Arsimore, të cilat lehtësojnë pjesëmarrjen në projekte dhe konferenca të përbashkëta. **[Sqarime 5.8; B3.2]** Raporti i stafit akademik me studentët është 1:14. **[Sqarime 5.9] [Kapitulli I Standardi III.1]**
- 5.2 UMSH-ja informon dhe komunikon me studentët e saj dhe të stafit akademik në mënyra të ndryshme. Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe e Karrierës është zyra qendrore që këshillon studentët dhe, për shembull, i informon ata për konkursat kombëtare dhe ndërkombëtare. Zyra drejtohet në mënyrë efikase, dhe të dyja palët si stafi, ashtu edhe studentët u shprehën të kënaqur, por nuk ka rregulla të shprehura qartë me shkrim dhe udhëzime për shërbimet që ofron kjo Zyrë. **[RVV fq.38; Sqarime 5.1 referuar vetëm në 1 Statuti i SHLPMSH, Nenet 14 dhe 38 dhe 2 Rregullore e SHLPMSH, Neni 18 dhe Kapitulli VI; M2; M5; M9; M12]** UMSH-ja përdor faqen e vet të internetit, emailin, rrjetet sociale dhe telefonin për komunikim të jashtëm, si dhe faqen e vet të internetit, emailin, tabelat e shpalljeve, sekretarët, stafin akademik dhe Këshillin Studentor për komunikim të brendshëm. **[RVV fq.38; M5]** I gjithë stafi ka email të brendshëm. **[M5; faqja e internetit]** UMSH-ja mban një dosje të plotë personale për secilin prej studentëve të tij, e cila përfshin një adresë email dhe një numër kontakti të çdo studenti; gjithashtu mban një dosje të plotë personale, e cila menaxhohet nga sekretaria mësimore. **[RVV fq.38; 4, Neni 50; M4] [Kapitulli I Standardi III.2]**
- 5.3 UMSH-ja orienton dhe drejton studentët e vet. Ai i udhëzon dhe i këshillon ata që nga momenti që shprehin interes për universitetin e deri pas diplomimit. Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe e Karrierës përsëri mban një përgjegjësi kryesore, e mbështetur nga stafi akademik, për të informuar dhe këshilluar studentët për kurrikulën, nëpërmjet diplomimit dhe duke shpresuar, edhe nëpërmjet punësimit. **[RVV fq.38; 19.1; 21; M5; M6]** Sekretaria mësimore monitoron dhe regjistron ecurinë e studentëve gjatë ndjekjes së studimeve në universitet dhe jep udhëzimet e duhura për studentët që duan të ndryshojnë programin e studimit në vitin e parë ose të dytë **[RVV fq.38; 4, Nenet 45, 46, 47; B4.17; M4]** (shihni gjithashtu pikën 5.6). **[Kapitulli I Standardi III.3]**

5.4 UMSH-ja mbështet studentët me nevoja të veçanta në mënyra të ndryshme. Bordi i Qendrës Mesdheu vendos për numrin dhe llojet e bursave studentore para fillimit të çdo viti akademik. **[RVV fq.39; 25, 1, Ndihma Financiare, b-d; M6; M12]** Institucioni gjithashtu paguan tarifën të plota shkollimi për kategori të veçanta shoqërore, duke përfshirë familjet në nevojë, fëmijët e punonjësve të policisë të rënë në krye të detyrës, studentë nga diaspora, studentë me aftësi të kufizuara, si dhe studentët nga grupet dhe komunitetet e pafavorizuara. **[RVV fq.39; 25, 1, Ndihma Financiare, a; M12]** Institucioni mbështet financiarisht studentët me nevoja të veçanta për karrige me rrota dhe lehtëson aksesin e tyre në ambientet e tij. **[M11]** UMSH-ja nuk dha dokumente/fakte bindëse sesi i mbështet studentët e angazhuar në sporte, megjithëse në vizitën e vlerësimit të jashtëm u përmend një farë mbështetje e kufizuar financiare për futbollin dhe volejbollin. **[RVV fq.39; Pyetësori i studentëve, 15.ix dhe 15.x; Sqarime 5.11; B1.1.2a-d; M3; M5; M6; M9]** Të gjitha programet janë me kohë të plotë; nuk ka asnjë dispozitë për programe me kohë të pjesshme. **[Kapitulli I Standardi III.4]**

5.5 UMSH-ja ofron literaturë bazë dhe mbështetëse për studentët. E gjithë literatura e rekomanduar e renditur në syllabusin e lëndës është e disponueshme në bibliotekë. Në shumicën e rasteve, të gjitha tekstet që u nevojiteshin studentëve për programet e tyre ishin ngarkuar paraprakisht në kompjuterat, por kjo nënkuptonte se ka pak hapësirë për të lexuar libra në format të shtypur. **[RVV fq.39; M9]** Biblioteka ka 15.000 tituj librash, tekste shkollorë, revista dhe materiale të tjera. **[RVV fq.39]** Ekziston një "bibliotekë elektronike" që përbëhet vetëm nga materiale të skanuara, por nuk ka biblioteka të tjera elektronike - edhe pse UMSH-ja është duke studiuar mundësitë për financim për të blerë disa të tillë. **[M9]** Nuk ka paketa programesh (softuerë) mbështetëse për përdorim nga studentët në bibliotekë; megjithatë, përdoren paketa të specializuara mbështetëse në departamente, për shembull, nga studentët e informatikës të ciklit të dytë dhe studentët e shkencave sociale. **[M9; M6]** Biblioteka, duke përfshirë burimet elektronike, mund të aksesohet vetëm brenda universitetit (shihni pikën 2.10). **[M9; M5]** Biblioteka përditësohet me blerjen e rregullt vjetore të teksteve të kërkuara nga pedagogët, por kërkesat për biblioteka online aktualisht kanë mbetur pezull. **[M12]** Studentët pohuan se biblioteka iu ofronte burime të mjaftueshme për të përfunduar me sukses programet e tyre të studimit. **[M5; M6]** Linja e buxhetit gjatë tre viteve të fundit për blerjet ka qenë 0.60 % në vitin 2015, 0.87 % në vitin 2016, dhe 1.57 % në vitin 2017, gjë që tregon se UMSH-ja është po i pasuron burimet e saj të bibliotekës në mënyrë të qëndrueshme. **[RVV fq.39; 25, 3 Blerjet dhe biblioteka elektronike]** Orari i hapjes së bibliotekës është i afishuar brenda ambienteve dhe në faqen e internetit të universitetit. **[RVV fq.39; <http://umsh.edu.al/fakultetet/sherbime/biblioteka> kontrolluar 24/04/17; 2, Neni 20]** **[Kapitulli I Standardi III.5]**

5.6 UMSH-ja i ofron mbështetje studentëve të ciklit të parë nëpërmjet stafit dhe shërbimeve të tij. Stafi akademik gjithmonë prezanton të gjithë përmbajtjen e modulit në mbledhjen e parë, duke përfshirë orientimin për gjetjen e literaturës dhe procedurat e vlerësimit. **[M5]** Tutorët gjithashtu udhëzojnë dhe këshillojnë studentët në studimet e tyre të mëtejshme, por disa tutorë këshillojnë deri në 200 studentë. **[RVV fq.38; M5; M11]** UMSH-ja harton një dokument të shkurtër të dobishme për studentët e saj, ku thekson elemente të tilla, si rregulla dhe procedura për procesin e mësimdhënies, duke respektuar kodin e etikës, rregulla administrative, transferimin e studimeve, mënyrat e pagesave dhe bursat. **[B4.17]** Nëse studentët kanë vështirësi dhe u nevojitet ndihmë shtesë akademike ose drejtuese, ata shkojnë tek pedagogët e tyre, të cilët trajtojnë shumicën e problemeve, por nëse këta nuk mund t'i ndihmojnë, studentët i referohen pedagogëve të cilët ofrojnë ndihmë shtesë. **[RVV fq.39; M2; M4]** Studentët e ciklit të dytë gjithashtu mbështeten për shembull,

nëpërmjet 15 takimeve të detyrueshme për konsultimin e tezës ndërmjet studentit dhe udhëheqësit. [**Kapitulli I Standardi III.6**]

- 5.7 UMSH-ja nxit studentët e vet që të marrin pjesë në jetën universitare. Ai mbështet Këshillin Studentor si nga ana logjistike, ashtu edhe financiare. [**RVV fq.40; 1, Neni 34; 36**] Rregulloret shprehin se Këshilli Studentor përbehet nga një student i zgjedhur për çdo klasë, [**36, Neni 11**], por dokumenti i politikave sugjeron se janë profesorët ata që i zgjedhin studentët nga çdo klasë. [**Sqarime 5.4; B5.4**] Këshilli Studentor ka faqen e vet të internetit [<http://umsh.edu.al/2016/12/20/keshilli-studentor-i-shlp-mesdhetare-e-shqiperise/>] dhe studentët komentuan mbi dobinë e kësaj. [**M6**] E drejta e studentëve për të dhënë mendimet e tyre për çështje që lidhen me jetën studentore shprehet në Rregullore. [**4, Neni 55, c**] Një përfaqësues i Këshillit Studentor shërben në Senatën Akademik dhe një përfaqësues tjetër i studentëve, Kryetari i Këshillit Studentor, bën pjesë në Këshillin e Fakultetit. [**1, Neni 15, 2 dhe Neni 18; 14 Neni 2;**] Çështjet e studentëve të ngritura dhe të trajtuara përfshijnë rritjen e bursave dhe ngritjen e një zyre të Këshillit Studentor. [**M3**] Studentët gjithashtu kanë të drejtën e përfaqësimit në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Kurrikulave, në Bordin e Administrimit, dhe Këshillat e Departamenteve, [**1, Nenet 17 dhe 18; Sqarime 5.4; B5.4 dhe 1.1.2.b**] Përfaqësimi jepet për çështje studentore vetëm në rastin e departamenteve. [**M4**] UMSH-ja ndihmon studentët për të organizuar disa aktivitete ekstrakurrikulare. [**RVV fq.40; M5; M6**] [**Kapitulli I Standardi III.7**]
- 5.8 UMSH-ja nuk ndjek një politikë të përshtatshme për të siguruar cilësinë kulturore dhe sportive të jetës studentore. Megjithëse vendndodhja gjeografike lehtëson transportin në qendrat shëndetësore, nuk ka ambiente shëndetësore brenda kampusit. [**RVV fq.40; M5; M9**] Studentët konfirmuan se megjithëse institucioni mbështet klube të ndryshme sportive studentore, duke përfshirë ekipet e futbollit, volejbollit dhe basketbollit, [**RVV fq.40; <http://umsh.edu.al/ekipi-i-futbollitvolejbollit-dhe-basketbollit/> - kontrolluar 24/04/17 dhe nuk funksionin**] nuk ka ambiente sportive brenda kampusit. [**Pyetëtori i studentëve, 15.ix dhe 15.x; Sqarime 5.11 duke iu referuar B1.1.2a-d; M3; M5; M6; M9**] UMSH-ja nuk paraqiti asnjë dokument që ky institucion ofronte “disa aktivitete kulturore”; [**Sqarime 5.14**] megjithatë, studentët dhe stafi drejtues përmendën kinemanë politike dhe biletat e teatrit. [**M3; M6**] Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstatoi se mungesa e një politike mbështetëse për të siguruar cilësinë kulturore dhe sportive të jetës studentore përbën **dobësi**. Ai **rekomandon** që UMSH në të ardhmen e afërt t'i kushtojë vëmendje hartimit të një politike për të siguruar cilësinë kulturore dhe sportive të jetës studentore. [**Kapitulli I Standardi III.8**]
- 5.9 UMSH-ja ndihmon në punësueshmërinë e studentëve në mënyra të ndryshme. Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe e Karrierës, së bashku me sekretaret e departamenteve, hartuan pyetësorë për studentët e diplomuar në Bachelor dhe morën mbi 400 përgjigje. Nga këta studentë, 61% janë punësuar (68% në fushën e tyre të specializimit dhe 32% jashtë fushës së tyre) dhe 39% janë të papunësuar. [**Sqarime 5.3; B1.14; M7; M12**] UMSH-ja ka hartuar një raport analitik mbi punësimin e studentëve që kanë përfunduar studimet në dy gradat Master: Master i Shkencave ose Master Profesional në Shkencat Ekonomike dhe Politike. [**18**] Është e paqartë nëse Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe e Karrierës mban statistikat e punësimit për të gjithë të diplomuarit e vet apo nëse prodhon analiza të ngjashme për të gjithë të diplomuarit e programeve të veta. Zyra është një pikë kontakti për praktika profesionale, të cilat janë të detyrueshme për të gjithë studentët, dhe të cilat janë mekanizmi kryesor nëpërmjet të cilit studentët ndërtojnë rrjetet e tyre personale dhe gjejnë punësim. [**RVV fq.41; 4, Nenet 27 dhe 28; B5.6**] Zyra bashkëpunon me të paktën 24 institucione, duke përfshirë edhe kompanitë private dhe zyrat e punësimit,

kryesisht për t'i caktuar studentët në praktikë profesionale, por edhe për të ofruar shërbime, të tilla si ndërtimi i pyetësorit dhe mbledhja e informacioneve për bizneset vendore. [19.1; M7] Shembuj të tjerë lidhur me suksesin e punësimit të studentëve përfshijnë një drejtor të përbashkët ekzekutiv, një partner në një kompani konsulente, që punon për investime të mëdha në Shqipëri, dhe një punonjës që punon në Bankën Qendrore të Shqipërisë. [M7] Senati Akademik ka miratuar një plan për të zgjeruar listën e marrëveshjeve. [19.1; 12, fq.25-26; B3; M2; M3] Alumni shpesh u shprehën se arsimimi i tyre ishte i përshtatshëm për qëllimin e botës së punës dhe punëdhënësit u shprehën se ata shpesh punësonin studentë që kishin zhvilluar praktikën profesionale pranë tyre. [M7] UMSH-ja ka ndjekur gjithashtu politika të favorshme për studentët më të mirë duke i punësuar ata në këtë universitetit. [RVV fq.41; 20; M11] [*Kapitulli I Standardi III.9*]

Gjykimi

Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë përmbushur kryesisht.

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi karakteristika të praktikës së mirë.

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësinë e mëposhtme:

- mungesa e një politike mbështetëse për të siguruar cilësinë kulturore dhe sportive të jetës studentore (pika 5.8; *Kapitulli I Standardi III.8*).

Rekomandimet

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimin e mëposhtëm:

- t'i kushtohet vëmendje në të ardhmen e afërt hartimit të një politike që siguron cilësinë kulturore dhe sportive të jetës studentore (pika 5.8; *Kapitulli I Standardi III.8*).

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohon veprime të ndërmarra.

Gjykimi

Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë përmbushur kryesisht.

Lista e dokumenteve

A. Lista e dokumenteve të fazës së vetëvlerësimit

(GID) Të Dhënat e Përgjithshme Institucionale.pdf

Lista e Përgjithshme e Dokumentacionit.pdf

RVV SHLPMSH.pdf

1. Statuti i SHLPMSH.pdf
 2. Rregullore e SHLPMSH.pdf
 3. Vendim i Qendrës Mesdheu_2014.pdf
 4. SHLP_Rregullore e FSHE.pdf
 5. Organigrama e SHLP "Mesdhetare e Shqipërisë".pdf
 6. Procedura e miratimit të programit të studimit në ciklin e parë të studimeve për Bsc në Drejtësi.pdf
 7. Procedura e miratimit të programit të studimit në ciklin e parë të studimeve për Msc në Drejtësi.pdf
 8. Procedura e miratimit të programit të studimit në ciklin e parë të studimeve për Bsc në Informatikë Biznesi.pdf
 9. Procedura e miratimit të programit të studimit në ciklin e dytë të studimeve për Master i Shkencave në SIB.pdf
 10. Rregullore e organizimit dhe funksionimit të NJSBCK.pdf
 11. Plan Strategjik i Zhvillimit Institucional, Kërkimit Shkencor dhe Bashkëpunimit 2012-2017.pdf
 12. Raporti Vjetor i SHLPMSH 2015-2016.pdf
 13. Rregullore e Senatit Akademik të SHLPMSH pdf
 14. Rregullore e Këshillit të FSHE.pdf
 15. Rregullore e Këshillit të Etikës.pdf
 16. Kodi i Etikës UMSH.pdf
 17. Kërkimi i tregut i SHLPMSH 2015.pdf
 18. Raport për punësimin e studentëve të Masterit SHLPMSH _2017.pdf
 19. 1 Listë e marrëveshjeve_SHLP_2017.pdf
 20. Lista e stafit të SHLPMSH 2016-17.pdf
 21. Lista e institucioneve për praktikën profesionale_ SHLPMSH.pdf
 - Aneksi 22 - Lista e lektorëve të huaj të ftuar në SHLP Mesdhetare e Shqipërisë.pdf
 - 23.1 Procedura e Rekrutimit.pdf
 - 23.2. Kontratë Individuale e Punës në SHLPMSH 2016-2017.pdf
 - 23.3. Kontratë Individuale Aneksi A 2016.pdf
 - 24.1 Formulari i vlerësimit të stafit SHLPMSH _2016.pdf
 - 24.2 Pyetësori i Studentëve _2016-17_ SHLPMSH.pdf
 - 24.3. Format e kontrollit të vlerësimit nga NJSBCK.pdf
 25. Struktura e buxhetit SHLPMSH _2017.pdf
 26. Përshkrimi i punës së koordinatorit të Fakultetit.pdf
 - Aneksi 27 - Të dhënat për programet e studimit të organizuara në SHLP Mesdhetare e Shqipërisë & broshura informuese e SHLP Mesdhetare e Shqipërisë.pdf
 28. MN në Anglisht.pdf
 29. Formulari i programit dhe vlerësimit të praktikës profesionale.pdf
 30. Udhëzues për tezën e Masterit dhe vlerësimin.pdf
 31. Udhëzues për procedurat e miratimit të ndryshimeve.pdf
 - 32.1. Udhëzues për përgatitjen e tezës së provimit të lëndëve_FES.pdf
 - 32.2. Udhëzues për përgatitjen e tezës së provimit përfundimtar_FES.pdf
 - 32.3. Udhëzues për përgatitjen e tezës së provimit përfundimtar_FES.pdf
 33. Rezultatet e pyetësorit të studentëve në SHLPMSH _03.2017.pdf
 34. Raport i NJSBCK 15_16.pdf
 35. Lista e aplikimeve në projekte_ SHLPMSH.pdf
 36. Rregullore e Këshillit të Studentëve.pdf
- Dokumenti i Vetëvlerësimit Shqip Mesdhetare.pdf

B. Lista e dokumenteve shtesë (Faza e vlerësimit në bazë të dokumenteve)

B1.1.1.a Procesverbal i mbledhjes së Bordit të Qendrës Mesdheu 12.2016.pdf

B1.1.1.b	Vendim i Bordit të Qendrës Mesdheu 12.2016.pdf
B1.1.2.a	Procesverbal i mbledhjes së Departamentit të Informatikës_ 09.2015.pdf
B1.1.2.b	Procesverbal i mbledhjes së Departamentit të Drejtësisë. _11.2014.pdf
B1.1.2.c	Procesverbal i mbledhjes së Këshillit të FES _12.2015.pdf
B1.1.2.d	Vendim i Këshillit të FSHJP _12.2016.pdf
B1.2	Propozim nga Këshilli i Etikës.pdf
B1.3	Urdhër i MAS _19.05.2017 Statusi dhe Statuti i UMSH.pdf
B1.5	Procesverbal i mbledhjes së Departamentit të FSHJP.pdf
B1.8	Raporti i pjesshëm i NJSBCK _2017.pdf
B1.9	Certifikatë e Bashkimit Europian _2015.pdf
B1.10	Projekti “Full Empowerment Zone Ahead” _2017.pdf
B1.11.1	Përditësimi i plan veprimit_2017.pdf
B1.11.2	Sërë vendimesh për hapjen e programeve, akreditimet _UMSH.pdf
B1.12	Evidencë e kërkimit të vazhdueshëm _2017.pdf
B1.14	Analizë për punësimin e studentëve të ciklit të parë _ SHLPMSH.pdf
B1.15	Lista e projektpropozimeve ndërkombëtare.pdf
B1.18.a	Evidencë për procedurat e stafit të huaj.pdf
B1.18.b	Draft strategjia për ndërkombëtarizim.pdf
B2.7	Sërë dokumentesh për organin e Auditit të Brendshëm.pdf
B2.10	Dokumentacioni për sigurinë.pdf
B2.11	Studimi i ndërtesës
B3.2	Evidencë mbi edukimin për bashkëpunim rajonal sipas departamenteve.pdf
B3.3.a	Vendimi i Senatit Akademik për kriteret e pranimit 2016_2017.pdf
B3.3.b	Vendimi i Senatit Akademik për kriteret e pranimit 2017_2018.pdf
B3.4	Certifikatë e kursit të trajnimit.pdf
B3.5	Kopje e Suplementit të Diplomës.pdf
B3.6.a	Evidencë mbi politikën e transferimit.pdf
B3.6.b	Evidencë mbi dosjen e transferimit të studentëve.pdf
B3.7	Kompetencat e studentëve për punë në të ardhmen.pdf
B3.8	Programet e javës së orientimit.pdf
B3.10	Procesverbal i mbledhjes, vendimet për programet Master dhe politikat e kërkimit.pdf
B3.11	Evidencë mbi MM dhe bashkëpunimin ndërkombëtar_UMSH.pdf
B3.12	Ngarkesa mësimore e stafit të institucionit.pdf
B4.2	Lista e praktikës profesionale të studentëve_2015-16.pdf
B4.3	Model i MM për praktikën profesionale.pdf
B4.6	Vlerësimi dhe procedura e ankimimit.pdf
B4.9.a	Evidencë mbi grupet e Kërkimit FSHJP.pdf
B4.9.b	Evidencë mbi grupet e Kërkimit FSHE.pdf
B4.11	Evidencë mbi koordinimin me institucionet analoge – Pyetje për programin IPA.pdf
B4.12	Politika për prioritetet e kërkimit shkencor.pdf
B4.14.a	Konferenca dhe publikime të FSHE.pdf
B4.14.b	Konferenca dhe publikime të FSHJP.pdf
B4.16	Kërkimi i vazhdueshëm dhe transferimi i rezultateve_UMSH.pdf
B4.17	Manuali i studentëve.pdf
B5.4	Përfshirja e studentëve në strukturat e SHLPMSH.pdf
B5.6	Procedurat e praktikës profesionale në SHLPMSH.pdf

C. Lista e dokumenteve shtesë (gjatë vizitës së vlerësimit)

C.1	Plani i veprimit i nxjerrë nga raporti vjetor i vitit paraardhës.pdf
C.2	Pyetësi i Alumni.pdf
C.3	Angazhimi për punësimin.pdf
C.4	Ngarkesa vjetore e punës për Departamentin e IMM.pdf
C.5	Procesverbal i mbledhjes dhe vendimi i Këshillit të Etikës.pdf
C.6	Alokimi i fondeve sipas kërkesave të departamenteve.pdf
C.7	Informacion për programet e studimit të ciklit të tretë në UMSH.pdf
C.8	Informacion për Bordin Këshillimor.pdf
C.9	Informacion për monitorimin e praktikës profesionale.pdf
C.10	Dokumentet e vlerësimit të praktikës profesionale.pdf
C.11	Lista e programit Erasmus.pdf

- C.12 Studim tregu Evropa-2020-alb.pdf
- C.13 Program trajnimi për stafin e ri mësimdhënës.pdf
- C.14 Informacion për Bordin Këshillimor.pdf
- C.15 Plan Veprimi për punën kërkimore 2016-2017.pdf

Mbledhjet

- M1 Mbledhja 1 Rektori
- M2 Mbledhja 2 Grupi i vetëvlerësimit
- M3 Mbledhja 3 Senati & Rektorati
- M4 Mbledhja 4 Përgjegjësit dhe sekretarët
- M5 Mbledhja 5 Studentët, cikli i parë
- M6 Mbledhja 6 Studentët, cikli i dytë
- M7 Mbledhja 7 Alumni dhe partnerët
- M9 Mbledhja 9 Turi në Universitet
- M10 Mbledhja 10 Profesorët dhe studiuesit
- M11 Mbledhja 11 Stafi mësimor
- M12 Mbledhja 12 Administrata